

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XIX, nr. 5935  
E mërkurë, 20 nëntor 2019  
çmimi 0.40 €

## Gjeneralmajor Michele Risi merr komandën e KFOR-it

FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

### OPINION

## HETIMET E REJA DUHET T'I ZBULOJNË VRASËSIT E ASTRIT DEHARIT F. 8

Shkruan:  
Bardhyl  
MAHMUTI



### AKTUALE



## GJATË KËTIJ VITI 1 600 MIGRANTË KANË HYRË NË TERRITORIN E KOSOVËS F. 6

## TËRNAVA TAKOHET ME MBRETIN E ARABISË SAUDITE, MERR MBËSHTETJE PËR KOSOVËN F. 7

### EKONOMI

## MEHMETI THOTË SE PËR SUKSESET E BQK-së KANË MERITË EDHE INSTITUCIONET VENDORE DHE NDËRKOMBËTARE F. 9


## SFIDË KRYESORE E KOMUNAVE, SHFRYTËZIMI I BUXHETIT F. 9



### SPORT

## KRASNIQI: FERONIKELI DO T'U RIKTHEHET FITOREVE F. 20


# FLET PËR "EPOKËN E RE", KIM MEHMETI SHENGEN BRENDAHQIPTAR, JO SHLYERJE TË KUFIJVE SHQIPTARO-SERBË



Shkrimtari dhe publicisti shqiptar nga Maqedonia e Veriut, Kim Mehmeti, ka kritikuar rëndë idenë e minishengenit ballkanik. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re" ai ka thënë se duhet të jesh injorant i pashoq që të besosh se Ballkanin pa kufij mund ta realizosh me burrshtetasit serbë të dalë nga kapota e Millosheviqit. Mehmeti ka bërë me dije se

Shqipëria duhet të merret me shengenin brendashqiptar e jo me shlyerje të kufijve shqiptaro-serbë. Sipas tij, me këtë veprim shqiptarëve u përcillet porosia se bashkimi kombëtar kalon nëpërmjet Beogradit. Në këtë intervistë Mehmeti ka folur edhe për zgjedhjet e 6 tetorit në Kosovë dhe për negociatat që po zhvillojnë LV-ja dhe LDK-ja për formimin e qeverisë së re

Regjistrohen 250 mijë dënime në sistemin qendror të evidencës penale I FAQE 5



## Analistët: Posti i presidentit s'duhet të përfshihet në bisedimet LV - LDK

Çështja e presidentit të ardhshëm të Kosovës pritet të përfshihet në bisedimet në mes të Lëvizjes Vetëvendosje (LV) dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) për marrëveshjen eventuale për koalicionin e ardhshëm qeverisës, por njohësit e rrethanave politike e kanë parë me skepticizëm një gjë të tillë. Shkëlzen Maliqi, Albinot Maloku dhe Faton Avdullahu kanë thënë për gazetën "Epokën e re" se posti i presidentit nuk duhet të përfshihet në këto bisedime. Sipas tyre, kjo çështje mund t'i komplikojë bisedimet për qeverinë e re ndërmjet dy partive politike



**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Curëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA** GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegijbiznesi.com  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.P.K.  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë, Viasa, p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

## Kriza politike, Meta takohet me ish-presidentin Rexhep Meidani

TIRANË, 19 NËNTOR - Në kuadër të takimeve për zgjidhjen e krizës, presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta ka pritur në zyrën e tij edhe ish-kreun e shtetit, prof. Rexhep

Meidani. Nuk jepen detaje të hollësishme të bisedës së zhvilluar midis tyre, por presidenti Meta konfirmon në rrjetet sociale se

kanë diskutuar për krizën e rëndë politike dhe institucionale në vend.

"Së bashku me ish-presidentin, prof. Rexhep Meidani diskutu-

am sot për zhvillimet më të fundit në vend dhe rëndësinë e zgjidhjes së krizës së rëndë politike dhe institucionale", ka shkruar Meta në rrjetet sociale.



## Ministri i Mbrojtjes i Italisë njoftohet me të arriturat në fushën e sigurisë në Kosovë



Në takime të ndara, presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi dhe kryeministri në largim, Ramush Haradinaj, e kanë falënderuar ministrin e Mbrojtjes të Italisë, Lorenzo Guerini, për rolin e Italisë në KFOR dhe për forcimin e paqes në përgjithësi në Kosovë dhe në rajon

PRISHTINË, 19 NËNTOR (ER) - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi dhe kryeministri në largim, Ramush Haradinaj, kanë pritur të martën në takime të ndara ministrin e Mbrojtjes të Italisë, Lorenzo Guerini, të cilin e kanë falënderuar për rolin e Italisë në KFOR dhe për forcimin e paqes

në përgjithësi në Kosovë dhe në rajon. "Jemi mirënjohës për kontributin e Italisë në KFOR dhe për përpjekjet e gjithanshme për ta forcuar paqen në Kosovë", është shprehur presidenti Hashim Thaçi. Duke folur për KFOR-in dhe komandantët italianë të forcës paqeruajtëse, presidenti Thaçi

është shprehur se "kam pasur bashkëpunim të shkëlqyer me Gjeneralmajorin D'Addario dhe mirëpres mundësinë për të vazhduar këtë bashkëpunim me gjeneralmajorin Risi". Ministri Guerini është i shprehur i lumtur që Italia ka kontribuar për forcimin e paqes në Kosovë dhe në tërë rajonin e Ballkanit.

Presidenti Thaçi shprehu edhe kënaqësinë që FSK-ja, në bashkëpunim me NATO-n, është bërë forcë profesionale, shumetnike, që i ka hapur perspektivë anëtarësimit të Kosovës në NATO në një të ardhme të afërt.

Ndërkaq kryeministri në detyrë, Ramush Haradinaj, ka vlerësuar

lart marrëdhëniet e shkëlqyera bilaterale mes dy vendeve tona. Haradinaj ka uruar që këto marrëdhënie të thellohen edhe më tej në të ardhmen dhe ka falënderuar shtetin e Italisë për angazhimin dhe përkrahjen dhënë Kosovës në procese të ndryshme, shumë të rëndësishme për vendin. "Si mike e Kosovës, Italia në vazhdimësi ka mbështetur perspektivën tonë të integritetit dhe ka qenë afër nesh në proceset jetike për konsolidimin dhe shtetbërjen e Kosovës", është shprehur kryeministri në detyrë, Haradinaj, njëkohësisht e ka njoftuar ministrin e Mbrojtjes të Italisë, Lorenzo Guerini, për përparimin dhe sfidat me të

cilat po përballet Kosova, veçanërisht në sferën politike dhe për të arriturat në sferën e sigurisë në vend.

Kryeministri në detyrë, Haradinaj, po ashtu ka theksuar se është më së i nevojshëm krijimi i institucioneve të Kosovës sa më shpejt që të jetë e mundur në mënyrë që proceset që kanë ngecur të ecin përpara. Ndërsa ministri i Mbrojtjes i Italisë, Lorenzo Guerini, ka falënderuar kryeministrin në detyrë, Haradinaj, për mikpritjen dhe bashkëpunimin e deritashëm në mes të Kosovës dhe Italisë, kurse ka shprehur gatishtësinë që këto raporte të zgjerohen edhe më shumë në të mirën e një partneriteti të mirëfilltë.

## Tryeza e OSBE-së për reformën zgjedhore dhe financimin e partive

Tiranë, 19 nëntor - Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian organizoi të martën në Tiranë një tjetër tryezë teknike për reformën zgjedhore, ku tema kryesore ishte financimi i partive politike.

Bashkëkryetarja opozitare e komisionit parlamentar të reformës zgjedhore, Rudina Hajdari, tha se "ekspertët e Këshillit të Evropës dhe të NDI-së po japin disa sugjerime të vlefshme mbi transparencën e financimeve partiake, e po ashtu pjesëmarrja e partisë demokratike me propozimet e veta". Ndërsa bashkëdrejtuesi

tjetër i komisionit parlamentar të reformës zgjedhore tha se "në këto takime po mblidhen edhe shumë sugjerime nga ekspertë vendas dhe nga partitë politike të opozitës, madje rregullimi i financimeve zgjedhore mund të reformojë edhe vet forcat politike nga brenda".

Opozita e bashkuar jashtëparlamentare ka tashmë platformën e saj "për çlirimin e zgjedhjeve nga krimi i organizuar", ku sipas përfaqësuesit të partisë demokratike, Ivi Kaso, "propozohet mes të tjerash ulja e kostove të fushatave dhe financimi i partive plotësisht nga shteti".

Por vëzhgues të shoqërisë civile ende janë skeptikë për suksesin e takimeve të tilla.

Drejtuësja e Shoqatës për Kulturë Demokratike, Gerta Meta, me një përvojë më shumë se dy dekada në vëzhgimin e proceseve zgjedhore, thotë se "këto takime përsëriten shpesh dhe thuhet të njëjtat gjëra, përsëri po humbet shumë kohë dhe ende nuk po dëgjohet një vullnet i qartë i partive për çështjet themelore, si depolitizimi i komisioneve zgjedhore, prekja e sistemit zgjedhor, përdorimi i teknologjisë apo votimi i emigrantëve".



Kryerja e reformës zgjedhore është edhe një nga kërkesat kryesore të ndërkombëtarëve,

ndërsa palët janë angazhuar që mund ta përmbyllin atë përpara krishtlindjeve të këtij viti.

Analistët politikë kanë komentuar idenë për përfshirjen e postit të presidentit në marrëveshjen për koalicionin e ardhshëm qeverisës LV - LDK

# Analistët: Posti i presidentit s'duhet të përfshihet në bisedimet LV - LDK

Çështja e presidentit të ardhshëm të Kosovës pritet të përfshihet në bisedimet në mes të Lëvizjes Vetëvendosje (LV) dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) për marrëveshjen eventuale për koalicionin e ardhshëm qeverisës, por njohësit e rrethanave politike e kanë parë me skepticizëm një gjë të tillë. Shkëlzen Maliqi, Albinot Maloku dhe Faton Avdullahu kanë thënë për gazetën "Epokën e re" se posti i presidentit nuk duhet të përfshihet në këto bisedime. Sipas tyre, kjo çështje mund t'i komplikojë bisedimet për qeverinë e re ndërmjet dy partive politike



EPOKA E RE

Muhamet KOCI

**PRISHTINË, 19 NËNTOR** - Njohësit e rrethanave politike në vend kanë bërë me dije se çështja e presidentit të ardhshëm nuk duhet të përfshihet në marrëveshjen eventuale për bashkëqeverisje në mes të Lëvizjes Vetëvendosje (LV) dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK).

Analistët politikë Shkëlzen Maliqi, Albinot Maloku dhe Faton Avdullahu kanë vlerësuar për gazetën "Epoka e re" se përfshirja e kësaj teme do t'i komplikonte negociatat e dy partive politike për koalicionin qeverisës. "Mendoj se çështja e presidentit nuk e ka aktualitetin e menjëhershëm, ndonëse po thuhet se do të jetë pjesë e marrëveshjes, fillimisht parimore. Ka pasur zëra që kërkonin shkarkimin e presidentit Thaçi, por mendoj se kjo nuk do të

ndodhë, pos nëse vetë presidenti nuk bëhet pengesë për qeverisjen e vendit. Mua më duket se presidenti Thaçi nuk do ta bëjë këtë duke pasur përvojën e keqe dhe dëmet e 'opozitarizmit' të presidentit Ilir Meta në Shqipëri", ka thënë analisti Shkëlzen Maliqi. Edhe njohësi tjetër i proceseve politike në vend, Albinot Maloku, ka vlerësuar se tradita e deritashme e përfshirjes së postit të presidentit në marrëveshjen për koalicionin qeverisës duhet të marrë fund. Sipas tij, subjektet politike duhet të pajtohen që presidenti i vendit të zgjedhet drejtpërdrejt nga populli. "Tradita e futjes së pozitës së presidentit në pazare politike besoj se duhet të marrë fund njëherë e mirë. Vendi ka president dhe kjo çështje nuk do të duhej të futej në diskutim. Rekomandimi i kahershëm, që të kemi president të zgjedhur nga populli, vazhdon

të këtë vend dhe unë pres që përmes reformës zgjedhore edhe kjo çështje të zgjidhet", ka thënë Maloku.

Kurse analisti tjetër politik, Faton Avdullahu, ka vlerësuar se nëse posti i presidentit bëhet pjesë e bisedimeve LV - LDK, do ta komplikojë marrëveshjen për qeverinë e re. "Fakti se tani kemi edhe një kartë të re të vendosur në tavolinën e negociatave për krijimin e qeverisë LV - LDK, atë të bërjes së z. Mustafa president të Kosovës, e komplikon këtë negociatë, për rrjedhojë, mbase, edhe e prolongon pajustifikueshëm. Duke pasur parasysh rrethanat në të cilën gjendemi sot, ku brengosshëm na shquan shkalla më e ulët e arritur ndonjëherë në dy dekadat e fundit e nivelit të raporteve me partnerët

ndërkombëtarë, ku s'kemi njohje të reja e po rrezikohemi me çnjohje, ku Serbia nuk perceptohet më si e 'çmendura e Ballkanit', ku BE-ja vazhdon të mos na përkëdhelë, prolongimet e mundshme për krijimin e qeverisë, për çështje se kush cilën ministri do ta ketë apo kush do të jetë kryeministër, janë moralisht të padenja e politikisht mund të jenë të dëmshme", ka deklaruar Avdullahu.

Lidhja Demokratike e Kosovës ka insistuar që në marrëveshjen për koalicionin në mes këtyre dy partive të përfshihet edhe posti i presidentit, kurse Lëvizja Vetëvendosje nuk ka preferuar shumë këtë çështje.

Lideri i LDK-së, Isa Mustafa, ka bërë me dije se insistimi në këtë çështje ka të bëjë me faktin se

nëse presidenti nuk zgjedhet në vitin 2021, atëherë vendi mund të shkojë në zgjedhje të reja. "Unë në asnjë rast nuk jam shprehur as nuk kam kërkuar që të jem president i Kosovës. Të tjerët kanë filluar ta bëjnë këtë punë të vëndosë problem, sepse për të do të vendosë partia që i takon, pra që ta propozojë kandidatin për president të ardhshëm të Kosovës. Ai propozim nuk do të bëhet tani, por do të bëhet kur e shpallen zgjedhjet për president. Tani për tani ne duhet të merremi vesh që ta kapërcejmë edhe këtë, sepse në qoftë se këtë nuk e bëjmë atëherë është një bindje e jona se pas një viti do të shkojmë në zgjedhje të reja", ka deklaruar Mustafa. Presidenti aktual i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka mandat kushtetues deri në vitin 2021.

## Haradinaj: Nuk ka kuptim të flasim për zgjedhje të reja



**PRISHTINË, 19 NËNTOR (ER)** - Kryeministri në largim, Ramush Haradinaj, ka thënë se Kosova nuk duhet të shkojë drejt zgjedhjeve të reja. Ai ka thënë se nuk ka asnjë kuptim që tani të flitet për zgjedhje. "Me rëndësi është që zgjedhjet janë zhvilluar në mënyrën më të mirë të mundshme dhe nuk duhet ta harrojmë këtë fakt. Ne duhet të bëjmë reformë zgjedhore dhe ta shkurtojmë kohën e ankesave, pra baza ligjore për ankesa duhet të ndryshohet. Nuk kemi bërë ankesa dhe as nuk kemi kërkuar stërzgjatje të këtij procesi. Jemi për implementim të rezultatit zgjedhor. Është herët të flasim për zgjedhje të reja, pra duhet të rrimë në pozicionin e implementimit të rezultatit zgjedhor", është shprehur Haradinaj në një konferencë për medie të martën pas takimit me ministrin e Mbrojtjes së Italisë, Lorenzo Guerini. Haradinaj ka thënë se qeveria e re duhet të krijohet duke u bazuar në rezultatit zgjedhor të 6 tetorit. "Nuk ka kuptim që të flasim për zgjedhje tash. Zgjedhjet nuk janë një ushtrim aq i thjeshtë dhe aq i lehtë. Ne duhet të respektojmë gjithë atë që ka ndodhur sepse sovranitë është deklaruar. Duhet të flasim për implementim dhe nëse dështon implementimi, atëherë kuptohet se duhet të shkojmë në zgjedhje", është shprehur Haradinaj.

Flet për "Epokën e re", Kim Mehmeti

# Shengen brendashqiptar, jo shly

Shkrimtari dhe publicisti shqiptar nga Maqedonia e Veriut, Kim Mehmeti, ka kritikuar rëndë idenë e minishengenit ballkanik. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se duhet të jesh injorant i pashoq që të besosh se Ballkanin pa kufij mund ta realizosh me burrështetasit serbë të dalë nga kapota e Millosheviqit. Mehmeti ka bërë me dije se Shqipëria duhet të merret me shengenin brendashqiptar e jo me shlyerje të kufijve shqiptaro-serbë. Sipas tij, me këtë veprim shqiptarëve u përcillet porosia se bashkimi kombëtar kalon nëpërmjet Beogradit. Në këtë intervistë Mehmeti ka folur edhe për zgjedhjet e 6 tetorit në Kosovë dhe për negociatat që po zhvillojnë LV-ja dhe LDK-ja për formimin e qeverisë së re

**EPOKA E RE****Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 19 NËNTOR -

**"Epoka e re":** Z. Mehmeti, pavarësisht prej premtimit, BE-ja nuk ua hapi bisedimet për anëtarësim Maqedonisë dhe Shqipërisë. Si e keni parë këtë qëndrim të BE-së?

**Mehmeti:** BE-ja nuk është as atë që ne mendojmë për të, as atë që ajo mendon për vetveten dhe që do të tregohet se është. Ajo është bashkësi shtetesh ku i ke të gjitha: nga ksenofobia e anti-islamizmi, deri te humanizmi dhe vlerat më të larta njerëzore, kështu që as ajo vetë nuk e ka të qartë se cila është fytyra e saj e vërtetë. Madje shpeshherë BE-ja duket si e zënë rob nga miti për vetveten. Dhe moshapja e bisedimeve me Maqedoninë e Shqipërinë thuajse e shpërfaq paqartësinë që BE-ja ka ndaj vetvetes, e jo ndaj vendeve që janë jashtë kufijve të saj.

E them këtë sepse pas anëtarësimit të Bullgarisë, Rumanisë... në BE nuk ka vend të Ballkanit që nuk e meriton të jetë pjesë e këtij unioni. Dhe e them këtë sepse kam përshtypjen se të joshur nga një BE e paramenduar - pra, jo nga ajo që me të vërtetë është, por nga ajo që e paragjykojmë, ne nuk shohim se për shumëçka ajo është njësoj si ne: me plot paragjykime, mosbesim e mosdurim ndaj të tjerëve. Në ndërkohë nuk duhet harruar se vendet e Evropës Perëndimore i rrënuan kufijtë mes vete, me çka dëshmuar se nuk janë pengë i kohëve kur ato mure u ngritën nga gjaku i rinisë së tyre, por nga rrënojat e kufijve të tyre ato ngritën murin e lartë të shengenit, i cili mur kontinentin e ndau në

pjesën ku jetonin të "mirët" dhe atë ku banojmë ne të "këqijtë" e Evropës, në ata që e jetonin të sotmen e kontinentit dhe ata që mbeten në baltën e së kaluarës së tyre. Me çka u krijua një gropë ndarëse mes Evropës Perëndimore dhe Ballkanit, një humnerë e cila ua pamundësonte ballkanasve të shohin se edhe shekulli i njëzetën i këtij kontinenti, shenjë njohëse ka ndasitë dhe kufijtë që të tregojnë nga cila anë e murit e ke vendin.

**"Epoka e re":** Po ashtu, BE-ja është duke zvarritur liberalizimin e vizave për Kosovën. Çfarë mesazhi po dërgon BE-ja për rajonin me këto veprime?

**Mehmeti:** Shtetet e Unionit Evropian dhe Ballkani janë dy portretet e të njëjtës zonjë të plakur. Shtetet perëndimore të Evropës dhe ato të Ballkanit janë si fytyra e grimuar dhe ajo e natyrshme e të njëjtës zonjë, e cila nuk arrin ta fshehtë të kaluarën e vet jo të moralshme dhe nuk ia del të përballet as me të sotmen e ndërtuar duke përdorur standarde të dyfishta. Dhe sot kur BE-ja i hoqi vizat për të gjithë ballkanasit, përpos për shqiptarët e Kosovës, ajo vetëm e tregon dyfytërsinë e saj. Zvarritja e vendimit për liberalizimin e vizave për Kosovën, më bindshëm se çfarëdo qoftë tjetër, e dëshmon se në Evropën Perëndimore dhe humane shumëçka ndryshon dhe korrigjohet, përpos mendësisë që prodhon standarde të dyfishta, mendësisë e cila, mbase, edhe solli deri tek ajo që fundi i shekulli të njëzetë, për këtë kontinent, të ketë të njëjtat shenja njohëse si edhe fillimi i tij: të fillojë me

# erje të kufijve shqiptaro-serbë



beteja të përgjakura dhe të përfundojë me varreza masive që i la pas vetes ushtria serbe e Millosheviqit. Fillim dhe fund që dallojnë vetëm në një gjë: përderisa gjatë luftërave të fillimshkullit të njëzetë, Evropa qartë kishte përcaktuar kufirin që ndante viktimën nga xhelati, ato të fundshkullit që përgjakën Ballkanin ajo i shpalli si çmenduri kolektive e të gjithë popujve të këtyre hapësirave. Me çka barazoi të pamundshmen - viktimën me xhelatin. Dhe ajo BE, para syve të së cilës ushtarakët serbë i ndanin të rinjtë dhe baballarët boshnjakë e shqiptarë nga nënat dhe gratë e tyre që t'i pushkatonin, sot ka hequr vizat për qytetarët serbë, por jo edhe për kosovarët?!

Pra, kjo Evropa e sotme tregohet humane dhe e kujdesshme ndaj qytetarëve të Serbisë, ndaj atyre në emër të të cilëve Millosheviq i përgjaku Ballkanin dhe vendosi t'i mbajë dyert e mbyllura për qytetarët e Kosovës. Pra, t'i mbajë matanë murit të shengenit ata të cilët, duke dashur të shpëtonin nga shfarosja fizike, u shpërndanë anembanë botës. Me shndërrimin e Kosovës në një 'gropë' nga e cila nuk dilet, BE-ja u tregua jo vetëm e padrejtë, por se është më e kujdesshme ndaj të "keqit" të cilin do ta bëjë të mirë sesa ndaj të "mirrit" që nuk ka zgjidhje tjetër përpos se t'i përulet asaj.

**"Epoka e re":** Së fundmi, Shqipëria, Maqedonia dhe Serbia kanë iniciuar idenë e një shengenit ballkanik. Cili është mendimi juaj për këtë iniciativë rajonale, e cila është kundërshtuar nga Kosova?

**Mehmeti:** Ideja për Ballkanin pa kufij është e vjetër aq sa edhe orvatjet serbe që Beogradi të jetë kryeqytet i këtyre hapësirave. Pra, ideja për një 'Serbosllavi' që do ta bashkojë Ballkanin Perëndimor, e ku bën pjesë edhe nisma e tanishme për "Shengenin e Ballkanit", kurrë nuk ka pasur për qëllim të realizojë atë që thuhet, por atë që mendohet. Andaj, duhet të jesh o injorant i pashoq, o pervers politik që të besosh se Ballkanin pa kufij mund ta realizosh me burrështetasit serbë të dalë nga kapota e Millosheviqit, me ata që 'Kasapin e Ballkanit' nuk e mallkojnë pse i përgjaku këto hapësira, por pse i humbi betejat, pse nuk e realizoi projektin e 'Serbisë së Madhe' dhe pse nuk i shfarosi shqiptarët e këtushëm dhe myslimanët e Bosnjës. Pra, me ata që nuk duan as t'u kërkojnë falje shqiptarëve për krimet që ua bënë në emër të popullit serb. Me një fjalë, duhet të kesh probleme të mëdha mendore e politike që si burrështetas shqiptar të mos merresh me 'Shengenin brendashqiptar', por

me shlyerjen e kufijve shqiptaro-serbë. Me çka popullit tënd ia përcjellë porosinë se bashkimin i tij kombëtar kalon nëpërmjet Beogradit dhe se ai bashkim është i pamundur pa mbështetjen e Serbisë! Pra, se shqiptaria e bashkuar kryeqytet e ka Beogradin!

**"Epoka e re":** Zgjedhjet e 6 tetorit në Kosovë sollën fitoren e LV-së. Çka ndikoi në sjelljen e këtij rezultati?

**Mehmeti:** Fitorja e LV-së në zgjedhjet e 6 tetorit shpërfaq lodhjen e Kosovës nga korrupsioni, keqeverisja dhe hajdutokracia. Fitorja e LV-së tregon se Kosova do t'i ndëshkojë burrështetasit e deritanishëm të saj që shkelën mbi ëndrrat e rinisë, ata që e bënë Kosovën të duket si vend që nuk ia del ta jetojë lirinë dhe që nuk di të bëhet shtet. Andaj Lëvizja Vetëvendosje ka mundësinë të bëhet fytyra e mençurisë politike mbarëshqiptare, por vetëm nëse arrin që Kosovën ta bëjë atë që të gjithë e ëndërronim - shtet të mirë për qytetarët, e jo për politikanët. Pra, LV-së i është dhënë mundësia të tregojë se çka e dallon partinë që i shërben popullit e shtetit nga ajo që i sundon ato. Dhe kryetari i LV-së ka mundësinë t'i tregojë mbarë shqiptarisë se çka e dallon politikanin që i është përkushtuar idesë dhe të mirës kombëtare nga ata që të mirën dhe fatin e popullit e barazojnë me karrierën e tyre politike dhe me mirëqenien e vet personale.

**"Epoka e re":** LV-ja ka filluar bisedimet me LDK-në për formimin e qeverisë së re. Si e shihni një qeverisje nga këto dy parti?

**Mehmeti:** E di se politika është art i së mundshmes, se për të më shumë vlerë ka pragmatizmi sesa parimet të cilat nuk i shkelur njeriu. E them këtë sepse unë nuk shoh ndonjë dallim të madh mes partive që gjatë kohë e kanë sunduar Kosovën, mes të cilave është edhe LDK-ja. E them këtë sepse, sikur të pyetesh unë, kurrë nuk do të bëja koalicion as me këtë parti. Mua më janë irrituese disa qëndrime e kushtëzime të LDK-së, e cila, në vend se ta falënderojë LV-në që do t'ia mundësojë shpëlarjen e pislëkut politik nga e kaluara, ende bënë naze e shitet e "virgjër". Edhe më tej besoj se si do që të bashkëpunojnë mes vete, mes LV-së dhe LDK-së do të mbetet dallimi që ato i ndanë po aq sa edhe qiellin e tokën: LV-ja e di si i ndihmohet dhe si i shërbehet Kosovës, e LDK-ja e di si sundohet e si zhvatet ajo. Pra, nuk do të jetë bashkëpunim i lehtë sepse LV-ja e sheh Kosovën si vend të cilit

gjithmonë i kanë munguar burrështetas që do t'i shërbenin asaj, e LDK-ja si shtet të cilit i mungojnë sundues që do të vazhdojnë ta zhvatën atë.

Sipas meje, drejtuesit e LDK-së thuhet me asgjë nuk dallojnë nga ata të 'Klanit Pronto'. Pastaj, siç duket, drejtuesit e saj kanë mendësi politike 'serbe', andaj atë që nuk mund ta arrijnë me votë, e realizojnë nëpërmjet shantazhit. Dhe duke qenë të tillë, ata janë mësuar që gjithmonë, dhe me cilindo, të jenë pjesë e qeverisë. Si dhe të sillen thuhet kurrë nuk e kanë drejtuar Kosovën dhe se nuk janë nga ata që vendit ia morën të gjitha, e thuhet nuk i dhanë asgjë.

**"Epoka e re":** Cilat duhet të jenë prioritetet kryesore të qeverisë së re?

**Mehmeti:** Më mbivlerësoni nëse besoni se mund ta njoh realitetin kosovar më mirë se ju që jetonin atje, por ajo që shihet edhe nga këtu ku jetoj, ka të bëjë me ikjen e të rinjve nga të gjitha trojet shqiptare dhe jo vetëm nga Kosova. Andaj e para që duhet ta bëjë Qeveria e re e Kosovës është ta ngjallë te të rinjtë besimin se asnjë vend tjetër nuk të jep aq sa vendlindja.

Për ta arritur këtë Kosova do duhet t'i shpjegojë vetvetes, edhe mbarë shqiptarisë, pse i ndodhi që edhe pas çlirimit të ketë burgje si ato të Millosheviqit, ku 'vetëvriteshin' shqiptarët. Pastaj Kosova duhet të shpjegojë si është e mundur që edhe pas çlirimit të ketë një sistem të organizuar policor, prokurorial e shtetëror, që me aq lehtësi rastet e vrasjeve i shpallë vetëvrasje.

Që Qeveria e re e Kosovës të dëshmohej se sjellë edhe mendësi ndryshe të drejtimit të shtetit, do të duhej të përgjigjej pse Presidenti i saj me aq lehtësi sot flet për vrasjet që kanë bërë të tjerët dikur e që ai i ka heshtur deri më tani?! Si dhe pse, për shembull, drejtuesve të LDK-së u kujtohen aktivistët e vrasë të partisë së tyre vetëm kur janë në opozitë, e jo edhe kur janë në koalicion qeverisës me 'Klanin Pronto'? Pasi t'u përgjigjet këtyre pyetje dhe pasi të shpjegojë pse mbeti shtet, ku ndodh edhe të të vrasin për pushtet, Kosova do ta kuptojë se deri në zgjedhjet e paradokohshme parlamentare ajo ishte duke e vuajtur robërinë e atyre që e sundonin me mendësinë millosheviqiane. Pra, do ta kuptojë se duhet ta nisë betejën për t'u çliruar nga robëria e mendësia politike që të shpallë armik dhe terrorist vetëm pse ka rrezik ta shpalosësh fytyrën e maskuar të pushtetarëve hajdutë dhe kriminelë.

# Regjistrohen 250 mijë dënime në sistemin qendror të evidencës penale

EPOKA E RE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 19 NËNTOR - Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor i Kosovës, Skender Çoçaj dhe zëvendëshefi i Zyrës së BE-së, Riccardo Serri, kanë vizituar të martën Gjykatën Themelore në Prishtinë, ku janë takuar me kryetaren Afërdita Bytyçi. Me rastin e kësaj vizite kanë diskutuar për të arriturat e gjykatës dhe për rëndësinë e funksionalizimit të Evidencës Qendrore Penale për gjyqësorin e Kosovës.

Kryesuesi Çoçaj ka thënë se deri tani janë regjistruar rreth 250 mijë lëndë penale si dhe për këtë projekt kanë krijuar një task-forcë të qëndrueshmërisë dhe pjesë e këtij plani do të jenë një numër procedurash. "Më lejoni ta përsëris Zyrën e BE-së për mbështetjen e vazhdueshme. Dënimet e regjistruara kanë arritur në 250 mijë. Gjykata Themelore e Prishtinës

është shembull për gjithë sistemin në vend. Regjistrimi i lëndëve penale do ta lehtësojë punën e gjyqësorit si dhe do të kursej kohë për qytetarët tanë", ka deklaruar Çoçaj.

Ndërsa zëvendëshefi i Zyrës së BE-së, Riccardo Serri, u shpreh se funksionalizimi i Evidencës Qendrore Penale është shumë i rëndësishëm për sundimin e ligjit. "Ky projekt është shumë i rëndësishëm për punën e gjyqësorit. Sundimi i ligjit është shumë i rëndësishëm për ne dhe rrugën drejt BE-së. Ky projekt iu mundëson qytetarëve që të marrin shërbime më lehtë", ka theksuar Serri.

Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Afërdita Bytyçi, ka thënë se nga ky projekt më së shumti do të përfitojnë qytetarët e vendit. "Ky projekt do të jetë i dobishëm për vendin tonë. Deri me tani janë regjistruar 90 për qind e lëndëve. Me këtë evidencë do ta eliminojmë çdo dilemë për



të kaluarën e çdo qytetari", ka thënë Bytyçi.

NCCR-ja është një projekt i financuar nga BE-ja që synon të sigurojë mbështetje për përfundimin e kornizës politike,

ligjore dhe administrative dhe strukturës teknike për krijimin dhe zbatimin e një Regjistri Qendror Kombëtar të Evidencës Penale (NCCR). Kjo do të mundësojë një regjistër

plotësisht funksional në nivel qendror dhe të gjykatave dhe do ta sigurojë lëshimin e certifikatave të besueshme lidhur me dënimet nga sistemi në pajtim me standardet ndërkombëtare.

## Gjatë këtij viti 1 600 migrantë kanë hyrë në territorin e Kosovës

PRISHTINË, 19 NËNTOR (ER) - Në Shkup është mbajtur "Forum i ministrave për drejtësi dhe punë të brendshme të Bashkimit Evropian - Ballkani Perëndimor", në kuadër të kryesimit të Finlandës me Këshillin e BE-së. Në këtë forum, ministri i Punëve të Brendshme, Ekrem Mustafa, para të pranishmëve ka biseduar për temat si: migracioni, terrorizmi dhe krimi i organizuar. Me këtë rast, ai ka thënë se menaxhimi i flukseve të migrantëve, luftimi i kontrabandimit me migrantë dhe menaxhimi i integruar i kufirit është prioritet kryesor, në të njëjtën kohë edhe sfidë kryesore. "Ndryshimi i rrugëve të lëvizjeve migratore e cila ka ndikuar në rritjen e numrit të migrantëve dhe refugjatëve në Ballkanin Perëndimor është reflektuar edhe në Kosovë. Gjatë këtij viti janë 1 600 migrantë që kanë hyrë në territorin e Kosovës apo 300 për qind më shumë se në vitin e kaluar", ka thënë ministri Mustafa. Ai ka bërë me dije se



deri më tani Kosova ka pasur kapacitete të mjaftueshme për trajtimin e të gjithë migrantëve, në përputhje me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e

të drejtave të njeriut dhe kryerjen e procedurave të nevojshme. Sa i përket çështjes së terrorizmit, ministri Ekrem Mustafa ka thënë se Qeveria e Republikës së

Kosovës është e përkushtuar që ta forcojë bashkëpunimin me të gjitha shtetet e rajonit pa dallim dhe të kontribuojë në përpjekjet e rajonit, Bashkimit Evropian dhe

Aleancës Globale kundër ISIS në parandalimin dhe luftimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit. "Ekstremizmi i dhunshëm dhe terrorizmi vazhdojnë të mbesin një nga kërcënimet kryesore të sigurisë vendore dhe globale. Reagimi efikas ndaj terrorizmit kërkon përfshirjen e të gjitha shteteve, agjencive ndërkombëtare të zbatimit të ligjit, shoqërisë civile dhe qytetarëve", është shprehur Mustafa.

Për temën e tretë, krimin e organizuar, ai ka thënë se një nga prioritetet kryesore për vitin 2020 është ngritja e kapaciteteve për zbatimin sa më efektiv të ligjeve të reja, por edhe forcimi i konceptit të policimit të udhëhequr nga intelijenca, hetimet e integruara financiare dhe luftimi i shpëlarjes së parave. Në këtë forum kanë marrë pjesë komisionari Dimitris Avramopoulos, ministrat e Brendshëm të Ballkanit Perëndimor dhe disa agjenci të BE-së, si: EUROPOL, EUROJUST, FRONTEX, EMCDDA dhe EASO.

## Batalioni i parë i BRSh-së përfundoi ushtrimin fushor "Partnerët 19"

PRISHTINË, 19 NËNTOR (ER) - Ditë më parë, Batalioni i Parë i Brigadës së Reagimit të Shpejtë të FSK-së, në nivel të kompanisë, në bashkëpunim me Komunën e Vitisë, Komunën e Kamenicës dhe njësitë e tyre emergjente kanë realizuar ushtrimin fushor "Partnerët 19". Sipas njoftimit të Ministrisë së Mbrojtjes, gjatë tra-

jnimit pjesëmarrësit kanë arritur një bashkëpunim të shkëlqyer në shkëmbimin e përvojave në procesin e planifikimit dhe menaxhimit të ushtrimeve të tilla. "Ushtrimi është realizuar në periudhë të ndryshme kohore. Në Komunën e Vitisë është mbajtur nga data 4 deri më 8 nëntor, ndërsa në Komunën e Kamenicës nga

data 11-15 nëntor. Pjesë e këtij ushtrimi, në rol vëzhgues, ishin edhe Komuna e Klllokotit dhe ajo e Artanës, me qëllim të informimit dhe familjarizimit me skemën e mobilizimit dhe reagimit të përbashkët në situata emergjente. Ushtrimi me autoritetet civile është planifikuar dhe ekzekutuar sipas Planit të Reagimit Kombëtar

dhe Sistemit të Integruar të Emergjencave, dokumente këto obliguese për bashkëveprim në situata të ndryshme të emergjencave civile", është bërë me dije në njoftimin e Ministrisë së Mbrojtjes.

Në këtë ushtrim kanë marrë pjesë edhe njësitë e specializuara të Gardës Kombëtare, Skuadra e



Kërkim-Shpëtim, EOD-ja, MKABK-ja dhe K9-ta.

Ndërrohet komanda e KFOR-it në Kosovë

# Gjeneralmajor Michele Risi merr komandën e KFOR-it

Në selinë e forcës shumëkombëshe të KFOR-it në Prishtinë të martën është zhvilluar ceremonia e ndërrimit të komandës. Komandanti i deritanishëm i KFOR-it, gjeneralmajor Lorenzo D'Addario, ia dorëzoi detyrën komandantit të ri të kësaj force, gjeneralmajor Michele Risi. Ky i fundit u shpreh falënderues dhe tha se shtetet aleate të NATO-s po kontribuojnë për sigurinë në Kosovë e më gjerë



**EPOKA E RE** **Faton DËRMAKU**

**PRISHTINË, 19 NËNTOR** - Në selinë e forcës shumëkombëshe të KFOR-it në Prishtinë është zhvilluar ceremonia e ndërrimit të komandës. Komandanti i deritanishëm i KFOR-it, gjeneralmajor Lorenzo D'Addario, ia dorëzoi detyrën komandantit të ri të kësaj force, gjeneralmajor Michele Risi. Në këtë ceremoni, e cila është mbajtur të martën, kanë marrë pjesë edhe presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, kryeministri në largim, Ramush Haradinaj, si dhe personalitete të tjera. Komandanti i ri i KFOR-it, gjeneralmajor Michele Risi, u shpreh falënderues dhe tha se shtetet aleate të NATO-s po kontribuojnë për sigurinë në Kosovë e më gjerë. "Dua t'i falënderoj 20 shtetet aleate dhe tetë shtetet partnere të cilat po i kontribuojnë sigurisë së tërë popullatës së Kosovës, për të cilën besoj fuqishëm se edhe është shtytësi kyç i stabilitetit të Kosovës dhe tërë rajonit", ka deklaruar Risi. Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë se ndonëse është ceremoni që në shikim të parë duket e njëjtë, në fakt çdo vit sjellë diçka të re. "Risia e parë që sjellë është një hap tjetër në

thellimin e bashkëpunimit në mes të KFOR-it, NATO-s në përgjithësi dhe institucioneve të Republikës së Kosovës. Risia e dytë është zgjerimi i bashkëpunimit në mes të KFOR-it dhe institucioneve të Kosovës, që dëshmohet me raportet për të arriturat e vazhdueshme, veçanërisht në bashkëpunimin me Forcën e Sigurisë së Kosovës. Dhe risia e tretë është hapi i madh drejt forcimit të paqes dhe sigurisë në Kosovë dhe në tërë rajonin tonë", ka thënë presidenti Thaçi.

Kreu i shtetit për punën e bërë e ka falënderuar komandantin e deritashëm të KFOR-it në Kosovë, gjeneralmajorin D'Addario. "Angazhimi juaj ka sjellë më shumë paqe, më shumë siguri dhe kjo ka ndikuar në jetë më të mirë për çdo qytetar të Kosovës", ka thënë presidenti Thaçi, duke i dëshiruar mirëseardhje komandantit të ri, gjeneralmajorit Michele Risi.

Thaçi ka thënë se edhe pas 20 vjetësh prani në Kosovë, KFOR-i vazhdon të jetë një prej organizatave që gëzon besimin më të madh të qytetarëve. "Ky besim i madh nuk është aspak i rastësishëm, por është krijuar falë punës profesionale, të paanshme dhe të suksesshme që ushtarët e KFOR-it e kanë

bërë gjatë gjithë këtyre viteve. Suksese jo vetëm në mbrojtjen e kufijve të jashtëm të Kosovës, të hapësirës ajrore të Kosovës, por veçanërisht në përkrahjen e Kosovës nga brenda. Këto suksese janë ndihmat që ofrohen çdo ditë, për çdo komunitet, në tërë Kosovën, për shkollat, spitalet, organizatat joqeveritare dhe mediat në vendin tonë. Besimi, bashkëpunimi, përkrahja, toleranca, bashkëjetesa, multietniciteti, paqja, janë vlera mbi të cilat është ndërtuar miqësia në mes të KFOR-it dhe çdo qytetari të Kosovës", u shpreh presidenti Thaçi.

Ai ka shtuar se çdo komandant i KFOR-it është angazhuar për ndërtimin e një komunikimi sa më të mirë me qytetarët sepse vetëm përmes komunikimit të mirë përçohen fuqishëm mesazhet e paqes, pajtimit dhe bashkëpunimit. "Sukseset tona të përbashkëta e bëjnë gjithnjë e më pak të nevojshëm KFOR-in. Reduktimi i vazhdueshëm i trupave të KFOR-it në Kosovë është treguesi më i mirë për

sukseset që kanë arritur ushtarët dhe udhëheqësit e KFOR-it. Këto suksese janë arritur edhe falë bashkëpunimit të ngushtë me mekanizmat vendorë të sigurisë", ka thënë ai.

Presidenti Thaçi ka thënë se nga bashkëpunimi i mirë është krijuar edhe Forca e Sigurisë së Kosovës, si një forcë profesionale dhe shumetnike, e cila është në shërbim të çdo qytetari të Kosovës. Ai ka shtuar se zhvillimi i FSK-së do të thotë se një ditë, në një të ardhme të afërt, do të realizohet aspirata jonë që jo vetëm NATO-ja të jetë në Kosovë, por që edhe Kosova të jetë në NATO, si dhe të kontribuojmë për paqen në tërë botën, me punën tonë dhe me shembullin tonë.

Kryeministri në largim, Ramush Haradinaj, ka thënë se Kosova është konsoliduar si shtet dhe ka fuqizuar mekanizmat e sigurisë falë rolit të NATO-s, duke u bërë sot një vend demokratik, i përkushtuar për paqe dhe partneritet me aleatët tanë. "Sot, në ceremoninë e ndërrimit

it të komandës së KFOR-it, falënderova Gjeneral D'Addario për angazhimin profesional dhe miqësor gjatë shërbimit të tij dhe i urova mirëseardhje Gjeneralit Risi, me urimet më të mira për sukses në detyrën e re. Kosova është e përkushtuar në rrugëtimin e saj drejt anëtarësimit në NATO dhe e fokusuar për paqe dhe siguri në vend dhe rajon dhe në këtë synim, roli i KFOR-it është i jashtëzakonshëm", ka thënë Haradinaj pas kësaj ceremonie. Hyrja e trupave të NATO-s, më 12 qershor 1999 në Kosovë, pasoi fushatën e sulmeve ajrore të Aleancës Veri-Atlantike kundër caqeve serbe në Kosovë dhe në Serbi që zgjati 78 ditë. Në Kosovë, në kuadër të KFOR-it, u vendosën rreth 50 000 ushtarë nga 36 vende, prej të cilëve 30 000 ishin nga vendet e NATO-s. Njëzet vjet pas kësaj ndërhyrje trupat paqeruajtëse të KFOR-it numërojnë nga 6 deri në 7 mijë ushtarë, të cilët janë të dislokuar në pjesë të ndryshme të Kosovës, me mision paqeruajtës.

## Tërnavë takohet me mbretin e Arabisë Saudite, merr mbështetje për Kosovën



**PRISHTINË, 19 NËNTOR (ER)** - Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës (BIK), myftiu Naim ef. Tërnavë, është prituri në takim nga Shërbëtori i Dy Xhamive të Shenjta, Mbreti Salman bin Abdulaziz Al Saud. Mbreti Selman i ka uruar mirëseardhje delegacionit nga Kosova, duke theksuar përkushtimin e Arabisë Saudite për të ofruar mirëqenie për të gjithë popujt e botës. Ai ka falënderuar myftiun Tërnavë dhe popullin e Kosovës për qëndrimet pozitive dhe

përkrahëse ndaj Arabisë Saudite, duke theksuar se në Arabinë Saudite gjenden dy vendet e shenjta dhe gjithashtu Kibla (drejtimi nga falen) e myslimanëve andaj, sipas tij, "është nder dhe obligim yni të kujdesemi për të gjithë myslimanët në botë". Më tutje, mbreti Selman ka theksuar përkushtimin e tij personal dhe të qeverisë së tij për të punuar për përhapjen e tolerancës dhe për luftimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit. Ai ka shprehur gatishmërinë e qeverisë

së tij për thellimin e bashkëpunimit mes dy vendeve për të mirën e dy popujve. Ndërsa myftiu Naim Tërnavë ka falënderuar mbretin e Arabisë Saudite për mikpritjen dhe për rastin për t'u takuar, duke theksuar se populli i Kosovës e falënderon Arabinë Saudite për përkrahjen e ofruar Kosovës në fusha të ndryshme në kohët më të vështira. Gjithashtu, Tërnavë ka falënderuar mbretin saudit për mbështetjen e Kosovës në arenën ndërkombëtare.

# Hetimet e reja duhet t'i zbulojnë vrasësit e Astrit Deharit



Shkruan: **Bardhyl MAHMUTI**

1. Pasi analizuan procesverbalet e hetuesisë, raportin e autopsisë së Institutit të Mjekësisë Ligjore në Prishtinë, rezultatet e punës së Agjencisë së Kosovës për Forenzikë, të dhënat për aspektet fizike, psikologjike dhe sociale, që kanë të bëjnë me vdekjen e Astrit Deharit dhe analizat e ADN-së që janë bërë në Zvicër, ekspertët mjeko-ligjorë të Qendrës Universitare Romande e Mjekësisë Ligjore në Lozanë dorëzuan te mandatarin i këtij hulumtimi dy ekspertiza: EI180001 TF/SG/jb, të datës 14 qershor 2019 dhe EI190001 SG/TF/VIC, të datës 9 shtator 2019.

Nga analizat e hollësishme të ekipit mjeko-ligjor zviceran dalin përfundimet e mëposhtme të cilat janë analizuar më gjerësisht në shkrimet paraprake:

- Deklarata e kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prizren, Sylë Hoxha, e datës 18 nëntor 2016, se gjoja "të gjitha provat dhe ekzaminimet demonstronin se ky rast ishte vetëvrasje" nuk është e saktë.

- Analiza që kanë bërë ekspertët zviceranë dëshmon në mënyrë të pakontestueshme, se edhe në hipotezën më ekstreme, në rastin nëse Astrit Dehari do të kishte dashur të bënte vetëvrasje, ai nuk do të kishte mundur t'ia zinte frymën vetes me një shishe plastike, në mënyrë siç e kanë shpjeguar ekspertët e Kosovës.

- Një vetëvrasje e tillë, praktikisht, nuk është e mundur, sepse kur ndërpritet furnizimi me oksigjeni organizmit, kemi "zvogëlimin ose ndërprerjen e tërësishme të ardhjes së gjakut të pasur me oksigjen në tru dhe kjo shkakton humbje të vetëdijes dhe të tonusit muskolor (tensionit të lehtë muskolor, që mundëson funksionimin e tyre edhe në gjendje qetësie). Humbja e tonusit muskolor e bën të pamundur që t'i zihet fryma vetes duke mbajtur një send në rrugët e frymëmarrjes. Nëse shishja është prej plastike,

me skaje të lëmuara, e rrumbullakët dhe pa kënde, ashtu siç ishte shishja plastike e mjalitit që u përdor kundër Astrit Deharit, ajo nuk do të kishte qenë në gjendje të qëndronte e bllokuar në faring në atë mënyrë, që të mund të pengonte tërësisht frymëmarrjen".

- Në aspektin teorik, një vetëvrasje me mjete të tilla do të kishte mundur të ndodhte vetëm në një skenar të imagjinuar: "Në rast se viktimat shtrihet në bark dhe në kohën kur e humb vetëdijen, shishja mbetet e bllokuar në mes të kokës dhe tokës dhe, në mënyrë efikase, vazhdon të mbyllë rrugët e frymëmarrjes. Mundësia e realizimit të një skenari të tillë nuk pranohet nga autorët që citoohen. Bëhet fjalë për një mundësi pa asnjë gjasë që të ndodhë, sepse duhet, gjithashtu, që të kemi parasysh, se gjatë fazës së shtrëngimeve muskulore që i karakterizojnë asfiksitet, lëvizjet e trupit do ta pengonin ruajtjen e këtij pozicioni, do të bënin që shishja të rrëshqiste ose të lëvizte dhe të liroheshin rrugët e frymëmarrjes. Megjithatë, përsëri duhet të nënvizojmë se skenari i fundit për të cilin folëm, nuk mund të merret parasysh në rastin e z. Dehari, sepse trupi i tij është gjetur i shtrirë horizontalisht në shpinë (dekumitusdorsal), ashtu siç është thënë nga të gjithë dëshmitarët".

Pra, sipas ekspertëve zviceranë, edhe në një hipotezë me skenar të imagjinuar, Astrit Dehari nuk e ka pasur të mundur të bëjë vetëvrasje, sepse trupi i tij është gjetur në një pozicion të tillë, që përjashton mundësinë që shishja plastike të vazhdonte t'i pengonte rrugët e frymëmarrjes. Për shkak të pamundësisë objektive që të kryejë vetëvrasje, në konkluzionet e ekspertizës së tij, ekipi mjeko-ligjor zviceran thekson se "vërtetësia e hipotezës së vetëvrasjes së z. Astrit Deharit, me mjetet që thonë mjekët ligjorë të Kosovës, duket e vogël" dhe që në konkluzionin e parë ata deklarojnë hapur se "kanë dyshime sa u

përket rrethanave të vdekjes së z. Astrit Dehari".

2. Për ekipin mjeko-ligjor shishja plastike nuk është mekanizmi i vetëm që është përdorur për t'i zënë frymën Astrit Deharit.

Lëndimet që Astrit Dehari ka pasur në pjesën e sipërme të ballit, në pjesën e poshtme të anës së djathtë të fytyrës, në pjesën e djathtë anësore të qafës, në parakrahun e djathtë dhe në shuplakën e dorës së djathtë, nuk janë lëndime sipërfaqësore që lidhen me bartjen apo transportin e trupit, por mavijosje, që shprehin lëndime të brendshme të indeve ose të organeve nga goditja me sende të forta, të cilat kanë qenë të shkaktuara në vendet karakteristike për lëndime, që bëhen gjatë kapjeve në qafë, të llojit "çelësi i krahut", ose nëpërmjet formave të tjera të dhunës në qafë".

Nga tërësia e lëndimeve të lartpërmendura, dhuna e shkaktuar në qafë është shenjë e pakontestueshme se, përveç shishes plastike, është përdorur edhe së paku një mekanizëm tjetër për të penguar rrugët e frymëmarrjes së Astrit Deharit. "Për shkak të këtij fakti, një mekanizëm i tillë i lëndimit nuk mund të përjashtohet dhe duhet të përmendet", - këmbëngulin ekspertët zviceranë.

3. Duke e argumentuar në mënyrë shkencore, se Astrit Dehari nuk ka mundur të bëjë vetëvrasje, në mënyrën si e kanë përshkruar ekspertët e Kosovës, dhe as që e ka pasur të mundur t'i shkaktojë vetes lëndimet e lartpërmendura, del qartë se vdekja e dhunshme e Astrit Deharit është vrasje.

4. Në rezultatet e analizës së ADN-së (Nr. Labo: 19-T03497), të përfshira në raportin e ekspertizës plotësuese (EI 190001), të datës 9 shtator 2019, përmenden një varg lëshimesh që janë bërë nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë. Për ilustrim ata përmenden faktin që Agjencia e Kosovës për Forenzikë nuk ka bërë analiza të ADN-së në mostrën e marrë nga ora e Astrit Deharit, me arsyetimin se gjoja mostra përmbante "pak ose aspak ADN". Për këtë çështje ata deklarojnë: "Nga mostra që kemi marrë prej të njëjtës ore, ne kemi mundur të nxjerrim profilin e ADN-së së një burri të panjohur, i emëruar në raport si H1. Ky rezultat lë të nënkuptohet se, sigurisht mund të nxirren profile të ADN-së edhe nga gjurmët e tjera që nuk janë analizuar nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë. Analiza të tilla mund të bëhen edhe nga ADN-ja, që tanimë janë nxjerrë nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë ose nga mostrat që ka realizuar Qendra

Universitare Romande e Mjekësisë Ligjore në Lozanë, për aq kohë sa ruhet materiali". Për këtë arsye kemi konkluzionin e tretë të ekipit mjeko-ligjor zviceran, nëpërmjet të cilit ky ekip shpreh gatishmërinë e tij për të kontribuar në ndriçimin e rastit "Astrit Dehari".

5. Ndriçimi i rastit "Astrit Dehari" nuk mund të ketë qasje tjetër, pos një hetim i plotë për të zbuluar vrasësit e Astrit Deharit. Çdo qasje tjetër do të ishte humbje kohe dhe nuk mund të interpretohet ndryshe, pos si përpjekje për të mbajtur të fshehur autorët e këtij krimi.

6. Nëse vërtet ka vullnet që të ndriçohet vrasja e Astrit Deharit, ushtruesi i detyrës së Kryeprokurorit të Prokurorisë Speciale të Kosovës, z. Afrim Shefkju, do të duhej t'i jepte menjëherë mandat Qendrës Universitare Romande të Mjekësisë Ligjore në Lozanë, që ekipi i ekspertëve të tyre të bëjë analizat e gjurmëve gjenetike në sendet që janë gjetur në

dhomën e krimit, të cilat nuk janë analizuar nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë, duke përfshirë edhe jastëkun me jargë që është gjetur në tokë, në dhomën ku Astrit Dehari është gjetur i vdekur nga zënia e frymës.

7. Krahas ndihmës për analiza gjenetike, Prokurori i Shtetit do të duhej të kërkonte ndihmën ndërkombëtare për një ekspertizë të dosjes së hetuesisë. Kjo dosje është përplot me kundërtënie, shfrytëzimi i së cilave do ta përshpejtonte nxjerrjen para përgjegjësisë të atyre që kanë kryer këtë krim të shëmtuar. Vetëm atëherë mund të merren si serioze angazhimet publike të Kryeprokurorit të Shtetit, z. Aleksandër Lumezit, për zhvillimin e hetimeve të pavarura, profesionale dhe kredibile në ndriçimin e plotë të këtij rasti".

(VIJON: Përgjegjësia e ekipit mjeko-ligjor të Kosovës për fshehjen e krimit)



## Kapen thika dhe municion në tregun e Suharekës

SUHAREKË, 19 NËNTOR (ER) - Sektori i Hetimeve në Stacionin Policor në Suharekë, pas pranimit të një informacioni se në tregun e gjelbër janë duke u shitur pajisje dhe gjësende të palejuara, në një aktivitet të realizuar së bashku me inspektorët komunalë dhe me njoftimin e prokurorit kujdestar, ka gjetur dhe ka sekuestruar: 5 shufra të metalit, 6 elektrohokë, 14 pako municion të pushkëve ajrore, 1 dylbi (të armës së zjarrit), 47

thika, 16 boksa të metalit, 6 pajisje për mirëmbajtje të armëve, 4 këllëf për shufër, 27 këllëf të armës dhe 7 këllëf për municion të pushkës së gjuetisë. "I dyshuari E. H., i lindur në vitin 1983, i cili i kishte në posedim këto pajisje, është proceduar në mënyrë të rregullt sipas urdhrat të prokurorit dhe me rastin po merren hetimet e Stacionit Policor në Suharekë", është bërë me dije në njoftimin e Policisë së Kosovës.



# Mehmeti thotë se për sukseset e BQK-së kanë meritë edhe institucionet vendore dhe ndërkombëtare

Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Fehmi Mehmeti, në Konferencën Ndërkombëtare të nivelit të lartë "rreziqet dhe mundësitë në një sektor financiar dinamik, rruga zhvillimore", e cila është mbajtur në kuadër të shënimit të 20-vjetorit të themelimit të BQK-së, ka thënë se pa ndihmën e institucioneve vendore dhe ndërkombëtare nuk do të ishte e mundur të arrihen sukseset që BQK-ja ka arritur deri më sot



## Bashkëpunimi në mes të bankave qendrore e bën më të lehtë tejkalimin e sfidave

Në punimet e sesionit të parë në kuadër të konferencës ndërkombëtare të nivelit të lartë, e organizuar nga BQK-ja në Prishtinë, me temën "Rreziqet dhe mundësitë në një sektor financiar dinamik, perspektiva zhvillimore", përfaqësues të lartë të Bankave Qendrore, Autoriteteve Mbikëqyrëse dhe të Institucioneve Financiare Ndërkombëtare (IFN-ve), në cilësinë e panelistëve dhe pjesëmarrësve kanë shkëmbyer përvojat e tyre gjatë diskutimeve, që ndërlidhen me sfidat dhe perspektivat e zhvillimit të qëndrueshëm të sektorit financiar në gjithë rajonin dhe më gjerë. Guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, Fehmi Mehmeti, në fjalën e tij ka thënë se sektori financiar po vazhdon të luajë rol të rëndësishëm në rritjen ekonomike pas krizës. Ai ka pohuar se bankat qendrore duhet edhe më tutje do të rrisin bashkëpunimin për t'i tejkaluar më lehtë së bashku të gjitha sfidat që u dalin përpara.

Ndërsa Gabriell Dibella, shef i misionit të Fondit Monetar Ndërkombëtar, ka folur në lidhje me marrëdhënien e rritjes dhe financave në përgjithësi, përfshirë edhe perspektivën rajonale. Panelistët dhanë vlerësimin e tyre se si do ta shihnin botën në 20 vjet dhe si do të duket peizazhi makroekonomik në Ballkanin Perëndimor, Evropë dhe në pjesën tjetër të botës.

**EPOKA  
ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 19 NËNTOR - "BQK-ja ka shënuar përparim të madh në të gjitha shtyllat e aktivitetit të saj, duke arritur të ndërtojë një sistem modern të pagesave dhe duke ofruar shërbime efikase të furnizimit me para të gatshme për ekonominë; kornizë rregullative financiare në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe kapacitete të avancuara mbikëqyrëse; statistika cilësore dhe analiza ekonomike e financiare të cilat u ofrojnë autoriteteve vendimmarrëse dhe publikut një kuptim të drejtë të zhvillimeve në ekonominë e vendit; si dhe në vazhdimësi ka treguar efikasitet të lartë për ofrimin e shërbimeve bankare për Qeverinë dhe qytetarët", kështu ka thënë guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Fehmi Mehmeti, në Konferencën Ndërkombëtare të nivelit të lartë "rreziqet dhe mundësitë në një sektor financiar dinamik, rruga zhvillimore", e cila është mbajtur në kuadër të shënimit të 20-vjetorit të themelimit të BQK-së. Ai ka thënë se pa ndihmën e

institucioneve vendore dhe ndërkombëtare nuk do të ishte e mundur të arrihen sukseset që BQK-ja ka arritur deri më sot.

Ndërkaq presidenti Hashim Thaçi, i cili ka marrë pjesë në shënimin e 20-vjetorit të themelimit të BQK-së, ka thënë se 20 vjet më parë janë vendosur themelet e Bankës Qendrore e Kosovës, ndonëse atëherë kishte një emër tjetër me mision më modest. "Në dukje ishte një hap i vogël, por në të vërtetë ishte një hap i madh, sepse aty u vunë themelet e sistemit të mirëfilltë bankar. Me këtë rast duhet t'i falënderoj të gjithë themeluesit dhe partnerët tanë ndërkombëtarë, në veçanti Fondin Monetar Ndërkombëtar për asistencën teknike që kishte dhënë", ka thënë ai.

Thaçi ka theksuar se me shpalljen e pavarësisë së Kosovës dhe miratimin e pakove ligjore përkatëse filloi një periudhë e re për BQK-në dhe për zhvillimin ekonomik të Republikën e Kosovës. "Që nga atëherë, BQK-ja ka shënuar suksese të mëdha, që kanë rezultuar me rritje ekonomike të vazhdueshme, me stabilitet financiar, me sistem modern të pagesave, me rregullim financiar dhe me

ngritje të kapaciteteve të avancuara mbikëqyrëse", ka pohuar presidenti Thaçi.

Në shënimin e këtij përvjetori presidenti Thaçi ka thënë se Banka Qendrore e Kosovës ka pasur rol të madh në integrimin ekonomik me vendet e zhvilluara, sidomos me ato të Bashkimit Evropian. "Mund të themi me krenari dhe me bindje të plotë se në këtë rrugëtim BQK-ja është model për krejt rajonin. Falë profesionalizmit dhe integritetit të BQK-së janë vetë qytetarët e Kosovës ata që kanë përfituar, që nga qasja më e lehtë në financim e deri te stabiliteti ekonomik që gëzojmë", ka thënë ai.

Kreu i shtetit ka theksuar se nga mekanizmat e ndërtuar ka përfituar edhe diaspora, pasi është ndërtuar një sistem financiar që i ka mundësuar diasporës një lidhje më të ngushtë me ekonominë e Kosovës. Ai e ka përgëzuar guvernatorin Mehmeti, gjithë stafin e BQK-së, guvernatorët e mëparshëm dhe të gjithë ata që kanë kontribuar në të kaluarën dhe kontribuojnë edhe sot. "I falënderoj edhe partnerët ndërkombëtarë, Thesarin Amerikan, USAID-in, Fondin

Monetar Ndërkombëtar, Bankën Botërore, Bankën Qendrore Evropiane, GIZ-in dhe shumë institucione të tjera për mbështetjen e vazhdueshme që i kanë dhënë këtij institucioni", ka thënë ai.

Presidenti Thaçi ka shtuar se në përvjetorë të tillë duhet të projektohen sfidat që e presin BQK-në dhe institucionet financiare të Kosovës. Një nga sfidat, sipas tij, është integrimi i mëtuftëshëm i sistemit tonë financiar me sistemet e vendeve të zhvilluara dhe plotësimin e të gjitha kriterëve të Sistemit Financiar të Kosovës për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian. "Po ashtu, sfida është edhe ruajtja e stabilitetit financiar që kemi dhe ndërtimi i mekanizmave që do ta mbajnë këtë stabilitet financiar. Me përkushtimin dhe aftësitë e treguara deri tani kam besim të plotë se BQK-ja do të jetë në gjendje të përballet me këto sfida", u shpreh presidenti Thaçi. Kreu i shtetit ka thënë se BQK-ja do të vazhdojë ta forcojë sistemin financiar dhe të luajë rol mbikëqyrës në zhvillimin ekonomik, duke promovuar parimet e ekonomisë së tregut të hapur dhe konkurrencës së lirë.

## Sfidat kryesore të komunave, shfrytëzimi i buxhetit

PRISHTINË, 19 NËNTOR (ER) - Auditori i Përgjithshëm, Besnik Osmani, ka marrë pjesë në takim të Këshillit të Kryetarëve të Komunave të Kosovës, në të cilin është diskutuar për raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA) për komunat e Kosovës. Me këtë rast, Osmani, duke theksuar rëndësinë e procesit të auditimit të komunave dhe zbatimin e rekomandimeve për përmirësimin e qeverisjes në nivelin lokal, ka thënë se raportet e auditimit janë një lloj ekzamini shumë i mirë për kryetarët e komunave që të kuptojnë se çka duhet të përmirësojnë në të ardhmen. "Është një mundësi e mirë të diskutojmë së bashku me ju të gjeturaturat e raporteve tona dhe



në të njëjtën kohë të marrim edhe një vlerësim nga ana juaj për punën tonë dhe për të gjitha shqetësimet që ju i keni në raport me Zyrën Kombëtare të Auditimit", ka thënë Osmani.

Ai ka shtuar se për t'u përmirësuar gjendja në komunat e Republikës së Kosovës janë shumë sfida, por ka zgjidhje. Sfidat kryesore kanë të bëjnë me shfrytëzimin e buxhetit.

"Përderisa ende kemi komuna që shfrytëzojnë vetëm 50 për qind të buxhetit vjetor tregojnë se flasim për një performancë relativisht të dobët në menaxhimin e buxhetit dhe kjo e zë një vend të merituar në raportet e auditimit, sepse kjo tregon qoftë për planifikim të dobët buxhetor apo për mungesë të kapaciteteve për ta shfrytëzuar buxhetin", ka theksuar ai.

Ndërsa kryetarët e komunave kanë vlerësuar punën e Auditorit të Përgjithshëm si dhe, pavarësisht prej vështirësive, ata kanë shprehur gatishmërinë për t'i zbatuar rekomandimet.

Nga Ministria e Financave, drejtori i Buxhetit, Salvador Elmazi, ka theksuar se, bazuar në rekomandimet e auditorit, "jemi duke

u munduar të gjejmë zgjidhje të qëndrueshme për zbatimin e rekomandimeve, në mënyrë që ato mos të përsëriten".

Në këtë takim që është organizuar nga Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) është diskutuar edhe për strategjinë e shtetit zviceran për përkrahje të komunave të Kosovës të cilën e ka prezantuar drejtoresha e Zyrës Zvicerane për Bashkëpunim, Katharina Stocker. Kurse strategjinë e shtetit suedez për përkrahje të komunave e ka prezantuar udhëheqësi për Bashkëpunim dhe Zhvillim, zëvendëshefe e misionit të Ambasadës së Suedisë në Kosovë, Nasrin Pourghazia.

## 'Komunat vazhdojnë ta shkelin Ligjin e prokurimit publik'

PRISHTINË, 19 NËNTOR (ER) - Iniciativa për Progres (INPO) dhe Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) kanë organizuar tryezën me temë "Prokurimi, sinonim i korrupsionit". Në këtë tryezë është bërë me dije se nga monitorimi i 160 aktiviteteve të prokurimit nëpër Komunat e Kosovës ka dalë se prokurimi publik vazhdon të jetë i cenueshëm, duke u zhvilluar me parregullsi në procedura dhe shkelje të Ligjit për prokurim publik.

Sipas raportit të prezantuar në këtë tryezë, mosplanifikimi i duhur i vlerave të kontratave publike ka bërë që të janë vonuar procedurat për për-

fundimin e punëve nga operatorë ekonomikë duke u përcjellë edhe me shumë parregullsi në procedura. Albulena Nrecaj, drejtoreshë ekzekutive në INPO, ka thënë se gjetjet tregojnë se ka shkelje flagrante të Ligjit për prokurim publik. "Në përgjithësi prokurimi në komunat e vendit është problematik. Mosplanifikimi i duhur i vlerave të kontratave ka bërë që të lidhen kontrata që tejkalojnë vlerën e shumës së planifikuar me buxhet ku është rezultuar me vonesa në pagesa duke bërë që operatorët të mos kryejnë punët dhe duke e dëmtuar edhe interesin komunal. Gjithashtu, gjetjet tregojnë se zyrtarët e



prokurimit aplikojnë kritere diskriminuese karshi operatorëve ekonomikë duke krijuar pabarazi në mes tyre", ka thënë Nrecaj. Ndërsa drejtori ekzekutiv i IKD-së, Ehat Miftaraj, ka thënë

se edhe kur gjatë procedurave të prokurimit bëhen shkelje, prokuroria respektive ka dështuar të trajtojë këto raste si pasojë e mungesës së kapaciteteve të gjykatave. Miftaraj ka thekuar se

është koha e fundit që të ndërmerren masa në mënyrë që në raste kur kemi keqpërdorime në aktivitetet e prokurimit keqpërdoruesit ta marrin dënimin e duhur.

## Lavdërohet puna e mësimdhënësve dhe drejtorëve të shkollave të Deçanit

DEÇAN, 19 NËNTOR (ER) - Rreth 600 nxënës nga Komuna e Deçanit kanë marrë pjesë në garën nacionale në Kreativitet Kulturor e Mendim Kritik dhe në Dituri. Nga ky numër 150 nxënës kanë qenë fitues në nivelin komunal dhe 12 në gara republikane. Për të diskutuar për këto suksese dhe sfidat në të ardhmen, koordinatori Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport, Rexhep Hoti, është takuar me kryetarin e Deçanit, Bashkim Ramosaj, drejtorin e Arsimit, Bekim Vishaj, bashkëpunëtorë dhe drejtorë të shkollave.

Kryetari Ramosaj ka thënë se është i kënaqur me gatishmërinë



e Drejtorisë së Arsimit dhe të drejtorëve për këto gara në nivel nacional, por ka kërkuar nga drejtorët dhe mësimdhënësit që

edhe më tepër të shtohet niveli i cilësisë dhe pjesëmarrja në këto gara. Ndërsa koordinatori Rexhep

Hoti ka thënë se është krenar me vullnetin e mësimdhënësve dhe të drejtorëve të shkollave në Deçan. "Për këtë sukses të

nxënësve pa dyshim se meritë është Drejtoria Komunale e Arsimit së bashku me drejtorët e shkollave të kësaj komune të cilët ndihmuan që për herë të parë nxënësve t'u realizohet një e drejtë kushtetuese", ka thënë Hoti.

Ndërsa drejtori i Arsimit, Bekim Vishaj, ka thënë se me vullnetin dhe punën e drejtorëve të shkollave kjo garë do të vazhdojë të nxjerrë në pah talent të rinj nga Komuna e Deçanit.

Koordinatori Hoti takimin e ka përmbyllur duke ndarë mirënjohje në shenjë falënderimi për drejtorët dhe stafin e Drejtorisë së Arsimit.

## Komuna e Skenderajt pranon donacion disa kamionë për njësitin e zjarrfikësve

SKENDERAJ, 19 NËNTOR (ER) - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, gjatë vizitës në Shtutgart të Gjermanisë, në një ceremoni zyrtare të organizuar në këtë shtet, ka pranuar donacion-kamionë me elemente përcjellëse të destinuar për nevojat e njësisë së zjarrfikësve të kësaj komune. Me këtë rast, Jashari ka thënë se ky donacion do të jetë në shërbim të qytetarëve dhe sigurisë së qytetit duke ndikuar në për-

mirësimin e kushteve për njësinë e zjarrfikësve në Skenderaj. "Gjatë vizitës në Shtutgart të Gjermanisë isha i nderuar të pranoj donacion-kamionë me elemente përcjellëse për nevojat e zjarrfikësve të komunës sonë, të cilët do të jenë në shërbim të qytetarëve dhe sigurisë së qytetit tonë. Falënderoj këshilltaren e shtetit, znj. Gisela Erlar, sekretarin z. Wilfried Klenk dhe kryetarët e komunave, Dornstadt z. Braig, Westerheim, z. Walz dhe Oberstenfeld, z.

Kleemann, të cilët dhuruan këtë donacion shumë të nevojshëm për zjarrfikësit tanë. Po ashtu, një falënderim për konsullin Lladrovci, falënderim i veçantë edhe për konsullin Besnik Miftaraj, i cili ishte organizator i kësaj ngjarje, si dhe falënderime për konsullatën tonë në Stuttgart, diplomatët tanë, të cilët janë shumë aktivë dhe po krijojnë ura bashkëpunimi në mes të institucioneve të Kosovës dhe vendit ku veprojnë", ka thënë Jashari.



## Dy qendra të mjekësisë familjare në kryeqytet pajisen me shtretër për pacientë

PRISHTINË, 19 NËNTOR (ER) - Komuna e Prishtinës ka bërë me dije se dy qendra të mjekësisë familjare në kryeqytet janë pajisur me shtretër të rinj për pacientë. Kjo

komunë ka njoftuar se investimet në infrastrukturën shëndetësore do të vazhdojnë edhe në të ardhmen. "Investimi për përmirësimin e vazhdueshëm, në infra-

strukturë dhe rritjen e cilësisë së ofrimit të shërbimeve shëndetësore, është i rëndësishëm. Qendrat e Mjekësisë Familjare numër 2 dhe 4 janë pajisur me shtretër të rinj për

pacientë, për të vazhduar edhe me qendrat e tjera në kryeqytet", ka njoftuar Komuna e Prishtinës, e cila udhëhiqet nga kryetari Shpend Ahmeti.



# OBELISKU I MIRËNJOHJES QË I MUNGON KOSOVËS (3)



Shkruan: Bedri ISLAMI

Në Kosovë, menjëherë pas demonstratave dhe marshimeve të mëdha të vjeshtës së vitit 1989, ku kishte pasur shumë të vrarë, kishte nisur krijimi i një lëvizje politike, e cila do të njihej si Alternativa Politike Kosovare, mes të cilave, më e njohura dhe dominuese, do të ishte Lidhja Demokratike e Kosovës.

Drejtuuesi i saj do të ishte kritiku dhe shkrimtari Ibrahim Rugova dhe, përreth tij, mjaft figura të njohura të botës akademike, të gazetarisë dhe artit e, më pas, do të bashkoheshin me të edhe shumë ish të burgosur politikë të Kosovës që do të ngjiteshin në elitën e lartë drejtuese të saj. Lidhja Komuniste e Kosovës, një filial faktik i Lidhjes Komuniste të Serbisë, do të shlyhej për pak ditë, sikur të mos kishte qenë, megjithëse pasojat e saj, do të ndiheshin disi më vonë.

Alternativa politike e Kosovës, që krijoi edhe një strukturë të përbashkët, ishte, si të thuash, pak ose aspak e njohur.

Perëndimi, në kohën kur po ndodhte ky proces në Kosovë, kishte halle më të mëdha me botën komuniste, e cila, edhe pse po shkatërrohej, do të sillte pas vetes disa nga problemet më të ndezura. Po ndodhte bashkimi gjerman, satelitët e shtetit dominues komunist, Bashkimit Sovjetik, po shkëputeshin njëri pas tjetrit, edhe brenda këtij gjëmëmadhi politik, BRSS, po krijoheshin detanta politike, por në qendrën e Ballkanit, këmbëngulësisht, një shtet po mbetej deri në fund një vend me pushtet komunist dhe diktatorial: republika e mbetur jugosllave, ku dominonte shteti serb.

Një alternativë politike e panjohur ishte fatale, por ajo nuk mund të bëhej e njohur vetvetiu, edhe pse ideja e saj e një lëvizje paqësore ishte joshëse. Liderët e saj ishin të njohur brenda Kosovës, por pak ose, aspak jashtë saj. Disa intervista të tyre në një periudhë të përplasjeve të ndjeshme nuk ishin të mjaftueshme për të bërë njohjen e tyre. Nga shtetet perëndimore evropiane ndihma ishte e vakët, në mos

mungonte, pasi Kosova nuk ishte prioriteti i tyre. Për më tepër, nuk kishte as kush ia jepte. Ata i trembte jashtëzakonisht mundësia e krijimit, nga i njëjti komb, shqiptar, të dy shteteve shqiptare.

Përpyekjet e Ismail Kadaresë, duke nxitur polemikat, duke dërguar letra drejt presidentëve evropianë, sidomos francezë, ku ai jetonte, kryeministrave, apo edhe botimi special i Veprës letrare të Ibrahim Rugovës në Francë, me një parathënie nga ai vetë, nuk ishin të mjaftueshme.

Në letrën që Ismail Kadare i shkruan Presidentit amerikan, George Bush, më 1 shtator 1991, mes të tjerave, guximshëm, ai ngre besimin që shqiptarët kanë tek Shtetet e Bashkuara dhe besimin se tek populli shqiptar do të kenë një mik besnik të përgjeshëm dhe se, "Ky është i vetmi popull në historinë e Evropës, që pas dy mijë vjetëve jetë u nda më dysh, që në fillim të shekullit të XX-të prej Fuqive të Mëdha. Ky është i vetmi komb, që në këtë shekull u shtyp prej dy diktaturave më të egra që ka njohur bota: diktaturës së komunistëve shqiptarë dhe diktaturës së komunistëve serbë. Me një krim të tillë në ndërgjegje, bota e lirë s'mund të flejë e qetë. Ndonëse nuk do të doja ta mbyllja këtë letër me diçka të zymtë, s'mund të rri pa ju thënë se shqiptarët e Kosovës i kanë bërë thirrje për ndihmë gjithë botës: një masakër e përgjakshme po përgatitet kundër tyre".

Dy profecitë e Kadaresë, njëra, për fat të mirë, angazhimi i ShBA-së në dobi të shqiptarëve dhe, tjetra, për fat të keq, masakra e përgjakshme, do të përjetohen në vitet 1998-1999. Për të bërë, si të thuash, zgjimin e vëmendjes amerikane drejt Kosovës, do të përfshihej gjerësisht lobi shqiptar në Amerikë.

Ai mori përsipër, ndoshta pa e shpallur, të bëhej klasa e re e ambasadorëve të Kosovës në Amerikë dhe njëkohësisht përfaqësuesit e saj të parë diplomatikë.

Për një kohë relativisht të shpejtë ata, me investimin e tyre jetësor, si figura të nderuara dhe qytetarë të respektuar amerikanë, krijuan rreth vetes një elitë senatorësh dhe kongresmenësh amerikanë, të cilët i lidhën me Kosovën, gradualisht, përmes mendimit dhe fakteve, deri sa e bënë lidhjen e tyre të qëndrueshme dhe të

dobishme.

Emra të njohur të politikës amerikane filluan të kenë interesim për Kosovën. Ata, edhe pse herë pas here kishin dyshimet e tyre, u bënë mbështetës të një lëvizje politike, krejt ndryshe nga sa kishte ndodhur deri asaj kohe në botën shqiptare, e cila nuk vuante nga mungesa e agresivitetit, të një lëvizje që mund të quhej gandiste, megjithëse kushtet ishin krejt ndryshe me Indinë e largët.

Këto senatorë dhe kongresmenë, emrat e të cilëve njihen tani, nuk u bënë vetvetiu të tillë. Ndoshta, ndonjëri, në fillimet e veprimtimit të tij mbështetës, kishte parasysh edhe këtë lobim si votues potencial, çka është e natyrishtme në politikë, por, më pas, duke e njohur seriozitetin e këtij lobi, pastërtinë e figurës së tyre, duke njohur faktin se ata shtyeshin nga një ndjenjë atdhedashurie dhe se askush prej tyre nuk kishte interesa financiare në Kosovë, e bënë këtë një çështje të tyre.

Nga një mungesë, çështja e Kosovës filloi të shfaqej në Kongresin apo Senatën amerikanë; nga një çështje e mbyllur, ajo filloi të hapet, ngadalë, por me ngulm; nga një harresë - ajo po fillonte të bënte një vend në kujtesën e politikës; pra, ndërsa po zgjohet, ndjente se tashmë nuk ishte më e braktisur. Ky ishte një mision i vështirë.

Deri asaj kohe klasa politike dhe lëvizja për pavarësi në Kosovë ishte njohur përmes dy tablove të ndryshme: klasa politike ishte e njohur si tolerante, ndoshta, në disa segmente të saj si bashkëpunuese e regjimit serb, ndërsa lëvizja për pavarësi, përmes shfaqjes së saj në marsin e vitit 1981 dhe tetor-nëntorin e vitit 1989, ishte shfaqur si agresive dhe, duhet pranuar, me tendencë marksiste, si një lëvizje për të fshehur irredentizmin e saj.

Lëvizja e re politike në Kosovë, që kërkonte të hiqte nga vetja këtë perceptim, pra si përfaqësuese e një lëvizje të re, thellësisht të re, tolerante ose bashkëpunuese me regjimin, ose thellësisht irredente, nuk mund ta bënte nga selitë e saj në Prishtinë.

U duheshin hapur dyert dhe, duke i hapur ato, së pari për të pranuar nga jashtë dhe, së dyti për t'u pranuar jashtë, në selitë diplomatike të Perëndimit, ajo mund të dëshmonte se dëshir

ronte vërtet të gjente një zgjidhje aspak tipike ballkanike, pra jashtë luftës.

Lobi shqiptar në Amerikë, megjithëse i largët, e njihte më mirë se gjithë të tjerët këtë strukturë politike të Kosovës, pasi, mbi gjithçka tjetër, ata ishin njohës më të mirë të politikës dhe të nëntokës së saj. Ata, duhet pranuar, ishin të parët që e dalluan këtë veçori dhe morën përsipër detyrën që, vetëm duke hequr këtë lëkurë politike që ishte vënë mbi lëvizjet politike në Kosovë, ata mund të bëheshin të pranueshëm dhe mund të ishin mikpritës.

Pra, duhej të hiqej ideja se Alternativa Kosovare nuk ishte asgjë tjetër veçse një lejim i pushtetit serb për të bërë një lojë pluraliste, pra të sillnin mendimin se liderët e rinj janë të besueshëm dhe mjaftueshëm për të qenë atdhetarë, dhe, së dyti, se, pas tyre nuk fshihej një lëvizje irredente, e vijës së majtë, e ngjashme me atë që kishte qenë në shtetin shqiptar.

Kjo është edhe periudha më e ngjeshur e lobimit në Amerikë nga shqiptarët, të cilët kishin krijuar brenda vetes elitën e saj politike.

Merita e tyre është se këtë e filluan nga poshtë, nga zyrat bashkërenduese të senatorëve e kongresmenëve, për ta ngjitur me përkushtim drejt vetë figurave të rëndësishme dhe për ta shpënë në zyrën Ovale të Shtëpisë së Bardhë.

Ky kalim, kaq i shpejtë, në një periudhë pak vjeçare, nuk kishte ndodhur me asnjë lëvizje tjetër politike, megjithëse kishte qenë më e shumtë dhe më e pasur. Nuk kishte ndodhur me irlandezët dhe nuk do të ndodhte as me lëvizjen separatiste baske ETA, për të mos përmendur këtu mohimin e bërë ndaj lëvizjeve ekstremiste kurde etj.

Rreziku që kishte mbi vete Kosova, e paraqitur nga politika dhe diplomacia serbe si vatër e konfliktit dhe e një treve të pacivilizuar, ishte shumë i madh dhe nuk mund të përballohej as nga shqiptarët e Kosovës, të sapoardhur në politikë, dhe as nga njerëzit e politikës në Shqipëri, të cilët ishin në hallin e tyre dhe nga të cilët, deklarata paternaliste dhe irredente, vetëm mund të prishnin punë.

Është, po ashtu, një periudhë kur propaganda shoviniste serbe është në kulmin e saj hapësinorë. E shtrirë kudo, ajo

ka vënë në lëvizje mendjet e saj të njohura, psikologë, shkencëtarë, gjeologë, historianë, shkrimtarë, mjekë, akademikë... të gjithë në përpjekjet e tyre mizore për të paraqitur shqiptarët e Kosovës si një popull barbar.

Njëri prej tyre, politikan e shkrimtar, që bëhet më pas edhe figurë qeveritare, Vuk Drashkoviç, në letrën dërguar Kadaresë, pikërisht në fillimin e kësaj përpjekje titanike, do të shkruante se "do të duhej të ftoheshin edhe psikologët e botës, që të vijnë në Kosovë dhe në Rrafsh të Dukagjinit, të hulumtojnë pse infermierët shqiptarë dhunojnë dhe mbysin lehonat serbe, pse mjekët i gjymtojnë fëmijët serbë... dhe që të verifikojnë hipotezat e veta, deri tani të pranuar, mbi përmasat e mundshme dhe të pamundshme të urrejtjes njerëzore... Fjala Kosovë për shqiptarët është gjeografi, kurse për serbët gurra e kulturës së tyre, është epi dhe feja, Alfa dhe Omega e ekzistencës së tyre".

Kjo përballje me vërshimin demagog serb, nga të gjitha anët dhe që gjen jehonë në median historikisht të lidhur me të, si në Francë apo Rusi, është e vështirë të përballohet nga njerëzit e politikës në Prishtinë, e, po aq e vështirë, në mos e pamundur, nga ata pak intelektualë që jetojnë në Perëndimin Evropian. Kjo hapësirë evropiane, për fat të keq, ishte zënë prej kohe nga vërshimi i politikës serbe, ndaj duhej gjetur një hapësirë e re, po aq e fuqishme, në mos edhe më tepër se kaq, e paanshme deri asaj kohe, me një të shkuar mbështetëse ndaj historisë dhe kombit shqiptar dhe, ky vend, nuk mund të ishte askush tjetër veçse në Shtetet e Bashkuara.

Lobi shqiptaro amerikan e mori përsipër këtë ç'përrallosje serbe dhe kjo ishte ndoshta më e vështira që mund të hasej. Duhej çmitizuar njëra palë, për të bërë të besuar palën tjetër. Me dhjetëra intelektualë shqiptarë të Kosovës do të gjejnë një mjedis të gatshëm, përgatitur nga lobi shqiptar në Amerikë, për të shpallur idetë e tyre, për të demontuar një mit të farkëtuar mjeshtërisht nga politika serbe e të gjithë sistemeve; ata gjejnë në mjediset amerikane njerëzit e duhur për të dëgjuar mendimin e tyre, për të polemizuar, për të kundërshtuar, për të përhapur të vërtetën e tyre.

(Vazhdon)

## SHBA: Tri media në Mal të Zi dezinformojnë me urdhër të Kremlinit

PODGORICË, 19 NËNTOR - E ngarkuara me punë në ambasadën amerikane në Mal të Zi, Judy Kuo, tha se tri media që veprojnë në tregun malazias, janë burime manipulimi, dezinformimi dhe të lidhura me Qeverinë ruse.

Duke folur në një konferencë në Podgoricë ajo tha se të rinjtë dhe

publiku i gjerë janë mjaft të ndjeshëm ndaj informacionit të rrejshëm dhe llojeve të ndryshme të manipulimit nga ana e medieve.

"Kush është burimi i këtij informacioni për publikun malazias? Mund të përmend disa kontribues kryesorë: 'Sputnik', i cili është direkt nën Qeverinë ruse, portale

në internet si 'IN4S' dhe 'Borba' të cilat janë të lidhura ngushtë me direktivat që vijnë nga Kremlini. Këto portale dhe disa 'shtëpi mediale' rajonale dhe lokale - nuk mendoj në ato që janë me të vërtetë media - janë mjaft aktive dhe shumë të koordinuara. Këto fushata kanë për qëllim të joshin publikun, të krijojnë rrëmujë dhe

të krijojnë probleme në shoqëri dhe midis vendeve", deklaroi ajo. Diplomati amerikane përmendi shembullin, kur mediet "me qëllim prezantuan histori të sajuaara për krijimin e bazave të NATO-s në Mal të Zi duke pretenduar se Mali i Zi mori pajisjet ushtarake për t'i përdorur kundër Serbisë dhe Rusisë".

"Sipas nesh, qëllimi i publikimit të gënjeshtreve të tilla, është të krijohet një klimë anti-NATO në Mal të Zi dhe ndasi mes njerëzve. Kjo është vetëm njëra anë e perspektivës së një fushate mirë të koordinuar, të udhëhequr nga Rusia, e cila gjithashtu përfshin mashtrimet kibernetike", tha diplomati Kuo.

# Vazhdojnë dëshmitë publike në procesin hetimor ndaj Trumpit

Disa figura aktuale ose të mëparshme të administratës kanë dëshmuar para Komisionit të Dhomës së Përfaqësuesve për Shërbimet e Zbulimi për mbledhjen e dëshmime në kuadër të hetimeve mbi presidentin Trump që mund të çojë në hapjen e procesit për shkarkimin e tij të mundshëm për abuzim autoriteti



UASHINGTON, 19 NËNTOR - Në Uashington po intensifikohet mbledhja e dëshmime në kuadër të hetimeve mbi presidentin Trump që mund të çojë në hapjen e procesit për shkarkimin e tij të mundshëm për abuzim autoriteti. Hetimet përqendrohen te roli që mund të ketë luajtur presidenti Trump në ushtrimin e presionit ndaj Ukrainës për të hetuar një rival politik. Një numër figurash aktuale ose të mëparshme të administratës po dëshmojnë para Komisionit të Dhomës së Përfaqësuesve për Shërbimet e Zbulimit.

Alexander Vindman është një ndër figurat qendrore me dijeni direkte nga bisedat e presidentit Donald Trump me homologun ukrainas.

Vindman, specialist për Ukrainën në Këshillin për Sigurinë e cilësoi si "të parregullt" kërkesën e presidentit Trump drejtuar presidentit Zelensky për të hapur hetime që kishin si objektiv pretendentin

presidencial demokrat, Joe Biden dhe familjen e tij, ka njoftuar vova.

Vindman ka qenë i përfshirë direkt në përgatitjen e pikave kryesore për bisedën mes dy udhëheqësve si në pranverë të këtij viti, ashtu edhe në 25 korrik, kur Trump i kërkoi udhëheqësit ukrainas t'i bënte një nder, duke hapur hetime mbi rivalin e tij. Vindman menjëherë raportoi lidhur me përmbajtjen e bisedës te këshilltari ligjor i Shtëpisë së Bardhë.

Në dëshminë e së martës ai përsëriti që kërkesa e bërë gjatë bisedës ishte, në pikëpamjen e tij, për interes vetjak politik të presidentit dhe jo në interes të vendit.

Presidenti Trump thotë se nuk e ka bërë këtë në telefonatë në thirrjen me presidentin ukrainas dhe se demokratët thjesht kërkojnë largimin e tij.

Habi për telefonatën e 25 korrikut shprehu edhe Jennifer Williams dëshmitarja tjetër në

sesionin e paradites, këshilltarja e nënpresidentit Mike Pence për Evropën dhe Rusinë.

"Më 25 korrik, së bashku me disa kolegë ishim të pranishëm dhe dëgjuaam telefonatën e presidentit Trump me presidentin Zelensky. Telefonata mu duk e pazakontë sepse, ndryshe nga telefonata të tjera presidenciale që kisha ndjekur, përfshinte diskutime që dukej se lidheshin me çështje të brendshme.

Williams nuk pranoi të shtonte komente të tjera lidhur me telefonatën. Ajo ia kaloi fjalën avokatit të saj, i cili shpjegoi se

zyra e nënpresidentit e trajton këtë si temë delikate, që nuk mund të diskutohet në një seancë publike dhe ajo do të ofronte përgjigje me shkrim për anëtarët e komisionit.

Të martën kanë ofruar dëshmitë e tyre edhe Kurt Volker, ish-përfaqësues i presidentit Trump për Ukrainën, si dhe Timothy Morrison, i cili ka shërbyer për një kohë të gjatë si ndihmës republikan në Kongres.

Presidenti Trump mbetet sfidues në komentet e tij, duke këmbëngulur se bisedat e tij me presidentin ukrainas nuk

kishin asgjë të parregullt dhe se demokratët janë të motivuar nga synime politike. Ai i ka akuzuar ata që kanë ofruar dëshmi dhe interpretime negative ndaj presidentit si zyrtarë me ngjyrim partiak, të betuar anti-trumpistë.

Seancat e kësaj jave janë të parat dëshmi që u kanë dhënë mundësi amerikanëve të dëgjojnë direkt dëshmi të zyrtarëve mbi zhvillimet e muajve të fundit që mund të shërbejnë si bazë për hapjen e procesit për shkarkim të mundshëm të presidentit.

## Stoltenbergu bën thirrje për unitet mes vendeve anëtare të NATO-s

BRUKSEL, 19 NËNTOR - Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg iu bëri thirrje aleatëve të ruajnë dhe forcojnë "unitetin" e tyre, duke thënë se organizata është "garantuesi i vetëm i sigurisë evropiane dhe transatlantike".

Stoltenberg, u tha gazetarëve të martën se NATO-ja "vetëm sa është bërë më e fuqishme në 70 vitet e fundit", me gjithë dallimet midis aleatëve për çështje të tilla si tregtia, ndryshimet klimatike, marrëveshja bërthamore me Iranin, dhe situata në verilindje të Sirisë.

Deklarata ai i bëri në prag të një

takimi të ministrave të jashtëm të vendeve anëtare të NATO-s, të cilët synojnë të përfundojnë përgatitjet për samitin e muajit të ardhshëm në Londër.

Ministrat e jashtëm të vendeve anëtare, në takimin e tyre, do të diskutojnë çështjet strategjike të Aleancës, përfshirë Rusinë, ndikimin në rritje të Kinës, të ardhmen e kontrollit të armëve dhe sigurinë e energjisë, tha Stoltenbergu.

Takimi do të trajtojë gjithashtu rolin e NATO-s në luftën kundër terrorizmit, përfshirë misionet e tij në Afganistan dhe Irak, për të cilat Stoltenbergu tha se "vazh-

dojnë të luajnë një rol të rëndësishëm në parandalimin e ringjalljes" të Shtetit Islamik dhe grupeve të tjera ekstremiste.

Sekretari i Përgjithshëm tha se përpjekjet e NATO-s për të luftuar kërcënimet për sigurinë kibernetike dhe dezinformimit, do të jenë gjithashtu në agjendë dhe njoftoi se "ekipi i parë i ndihmës" është në Mal të Zi këtë javë.

NATO-ja krijoi ekipe të tilla vitin e kaluar, për të ofruar ndihmë ndaj aleatëve, si përgjigje ndaj propagandës dhe taktikave të tjera jo-ushtarake.

Sekretari i Përgjithshëm tha se



ai po planifikon të zhvillojë bisedime me presidentin e Francës, Emmanuel Macron, javën e ardhshme, pasi presidenti francez deklaroi se NATO-

ja po përjeton "vdekjen e trurit" të saj, për shkak të mungesës së parashikueshmërisë së Uashingtonit, nën udhëheqjen e presidentit, Donald Trump.



## AUTOSHKOLLA "RITMO - L"

**Auto Shkolla  
"RITMO - L"  
Prishtinë**

**Eksperienca jonë  
- përfitimi i juaj.**

**Ju mirëpret:  
Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "**

**Tel / kontakt:**

**044 248 173**


**044 200 604**

**044 375 333**

**E rrallë**

## Pamjet tronditëse të mushkërive të zeza të duhanpirësit

Pamjet tronditëse tregojnë mushkëritë e nxira nga katrani të një duhanpirësi, i cili e piu për 30 vjet rresht. Në vend se të ishin ngjyrë rozë të shëndetshme, mushkëritë kishin ngjyrë qymyri nga mbetjet e duhanit gjatë dekadave. Mjekët nga spitali Wuxi People në Kinë, pasi vdiq, nxorën organet e një 52-vjeçari, i cili kishte shumë sëmundje



në mushkëri. Video e regjistruar nga kirurgët është parë më shumë se 25 milionë herë në mediat sociale dhe konsiderohet "reklama më e mirë kundër pirjes së duhanit".

**FOTO E DITES**



Aeroplanët francezë shfaqin flamurin e Francës gjatë një shfaqjeje në Emiratet e Bashkuara Arabe /AP/

**E jashtëzakonshme**

## Tre mijë kristale "Swarovski" në pemën e Krishtlindjes

Në Danimarkë është hapur zyrtarisht sezoni i Krishtlindjes, ndërsa në sheshin e Kopenhagenit është vendosur një pemë dhjetë metra e dekoruar me rreth 3 000 kristale "Swarovski". Sheshi tanimë ka marrë një pamje krejtësisht nordike.



Pema e Krishtlindjes, me kristale me vlerë rreth 146 000 dollarë, qëndron para hotelit "Nimb" në bazat e Tivolit.

**BARSOLETA E DITËS**



Një fëmijë i vogël rrihet nga fqinja. Nëna e tij shumë e nevrikosur shkon për t'i kërkuar shpjegime:  
 - A mund ta di pse e ke rrahur djalin tim?  
 - Është i paedukuar. Më tha trashaluçe.  
 - Dhe çfarë mendoni ju zonjë, se duke e rrahur djalin tim do të dobësoheni?



**Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC**

Vetem gjatë vikendit në ora 14:00

### ABOMINABLE 3D

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 ore 32 min

Rolet: Chloe Bennet, Tenzing Norgay Trainor, Albert Tsai, Eddie Izzard, Sarah Paulson, Tsai Chin, Michelle Wong, etj.  
 Regjia: Jill Culton



Çdo ditë në ora 16:00

### TOY STORY 4 / 3D

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 40 min

Rolet: Tom Hanks (Woody), Annie Potts (Bo Peep), Tim Allen (Buzz Lightyear), Tony Hale (Forky), Keegan-Michael Key (Ducky), Jordan Peele (Bunny), Wallace Shawn (Rex), John Ratzenberger (Hamm), Keanu Reeves (Duke Caboom), etj.  
 Regjia: Josh Cooley



Çdo ditë në ora 18:00 dhe 20:00

### MALEFICENT MISTRESS OF EVIL 3D

Aventurë/Familjar/Fantazi; 1 orë 58 min

Rolet: Angelina Jolie, Elle Fanning, Chiwetel Ejiofor, Sam Riley, Ed Skrein, Imelda Staunton, Juno Temple, Michelle Pfeiffer, etj.  
 Regjia: Joachim Ronning



Çdo ditë në ora 22:00

### ZOMBIELAND DOUBLE TAP

Aksion/Komedi/Horror; 1 orë 39 min

Rolet: Woody Harrelson, Jesse Eisenberg, Emma Stone, Abigail Breslin, Rosario Dawson, Zoey Deutch, Luke Wilson, etj.

Regjia: Ruben Fleischer



**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**

 <p><b>DASHI</b> Mjaft harmoni në punë ndërmjet kolegësh. Pak problematik raporti në çift. Dikush po ju kërkon shpjegime.</p>	 <p><b>DEMI</b> Sot do të jenë emocionet tuaja ato që do t'ju drejtojnë në zgjedhjet që do të bëni.</p>	 <p><b>BINJAKËT</b> Keni mjaft mirëkuptim në familje ku secili bën atë që i takon duke ju lënë kohë të lirë në dispozicion.</p>	 <p><b>GAFORRJA</b> Jeni disi ëndërrimtarë gjatë pjesës së parë të ditës. Shumë shpejt një problem do t'ju kthejë me këmbë në tokë.</p>	 <p><b>LUANI</b> Sot po e kapni veten shumë herë duke menduar për të shkuarën. Doni të qëndroni vetëm me kujtimet tuaja.</p>	 <p><b>VIRGJERESHA</b> Jeni shumë korrekte sot me detyrimet tuaja. Nëse do të kishit një reciprocitet dhe nga personat e tjerë dita do të ishte perfekte.</p>
 <p><b>PESHORJA</b> Hëna në shenjë sot ju bën romantike më tepër se zakonisht. Shumë mirë paraqitet dhe ana juaj financiare.</p>	 <p><b>AKREPI</b> Logjika dhe racionaliteti nuk ju mungojnë sot. Kjo do t'ju shërbejë dhe miqve tuaj që shpesh herë janë tepër impulsive.</p>	 <p><b>SHIGJETARI</b> Sot do të keni një jetë sociale me mjaft angazhime. Autokontrolli shumë herë ju ka privuar nga kënaqësi të vogla.</p>	 <p><b>BRICJAPI</b> Intuita juaj po ju paralajmëron për një ngërç të vogël në jetën në çift. Mundohuni të gjeni arsyen pse ka ndodhur.</p>	 <p><b>UJORI</b> Sot dëshira juaj shkon tek kreativiteti gjërat e bukura dhe udhëtimet. Do të keni nevojë për shoqëri të mirë.</p>	 <p><b>PESHQIT</b> Sot ngado që shkoni gjendeni në shoqëri të mirë dhe me miq të këndshëm. Do të ndiheni disi të plogësht gjatë mbrëmjes.</p>

## Kylie Jenneri shet kompaninë e kozmetikës për 600 milionë dollarë



**K**ylie Jenner ka vendosur ta shesë pjesën më të madhe të kompanisë së kozmetikës për 600 milionë dollarë. Marka e 22-vjeçares, përfshirë Kylie Cosmetics dhe Kylie Skin, do të kontrollohet nga gjiganti i


bukurisë "Coty". Kylie thotë se po shndërron markën në një "qendër ndërkombëtare të bukurisë". "Forbes" ka raportuar se ajo bëri 360 milionë dollarë shitje në vitin 2018, duke e bërë atë miliarderen më të re.

## Kevin Hart shihet në ndeshje basketbolli pas aksidentit të rëndë



**T**eksa vazhdon shërimin nga dëmtimi që pësoi në aksidentin me makinë, komediani Kevin Hart u pa në 'Staples Center', së bashku me gruan Enniko Parrish. Ata ishin të pranishëm në ndeshjen në mes të Lakersit dhe Atlanta Hawksit. Ai ende është duke u rikuperuar para

se t'i fillojë aktivitetet në fushën e aktrimit. Aktori dhe komediani 40 vjeç u ul përkrah gruas së vet Enniko Parrish, 35 vjeç dhe po shijonin çastet e ndeshjes në kuadër të NBA-s. Kevin Hart dukej në humor të mirë, teksa takoi edhe shokët, reperët 2 Chainz, Offset dhe Quavo.




## Taylor Swifti nderohet me një tjetër çmim të madh

**T**aylor Swift, pasi u njoftua se do ta marrë çmimin "Artistja e Dekadës" më 25 nëntor në American Music Awards 2019, do të nderohet me një tjetër çmim të madh. Këngëtarja është e para artiste që do të vlerësohet me çmimin "Gruaja e Dekadës" nga

Billboard. Swift do të nderohet në ngjarjen Women in Music Event 2019 më 12 dhjetor në Hollywood Palladium në Los Angeles. Billboard do t'i japë çmimin yllit të muzikës, e cila vlerësohet si një nga artistet më të realizuara të të gjitha kohëve, pas vitit 2010.

## Kanye West thotë se ai është artisti më i madh që ka krijuar Zoti



**K**anye West është shumë e sigurt në artin e vet. Reperi 42-vjeçar ka thënë se Zoti po e thërret atë për një kohë të gjatë, ndërkaq djalli e ka larguar atë për një kohë të gjatë. "Kur isha në pikat e mia më të ulëta, Zoti ishte me mua

dhe dërgoi vizione duke më frymëzuar. Unë jam këtu në shërbim të Zotit dhe asnjë armë e formuar kundër meje nuk do të ketë sukses. Tani jam artisti më i mrekullueshëm që Zoti ka krijuar ndonjëherë", tha reperi duke qeshur.

# Akademia Suedeze i përgjigjet kryeakademikut Kraja: E vlerësuam veprën e Handkes, jo atë



Akademia Suedeze ia ka kthyer letrën kreut të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, Mehmet Krajës, lidhur me kërkesën e këtij të fundit që të anulohet çmimi Nobel, i dhënë për shkrimtarin austriak proserb, Peter Handke.

“Të zhgënjyer thellësisht me ndarjen e sivjetshme të Çmimit Nobel, Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës kërkon të anulohet ky

vendim i Akademisë Suedeze, si akt mirëkuptimi e solidariteti me të gjithë popujt e botës që luftojnë për liri dhe vlera demokratike”,

kishte shkruar Kraja në letrën e tij dërguar akademisë suedeze më 10 tetor 2019, ku kishte numëruar radhazi gjithë ato që Handke

kishte thënë për regjimin e Millosheviqit.

Ndërkohë në letrën që Akademia Suedeze i ka kthyer Krajës thuhet se Çmimi Nobel për Letërsi i është dhënë Peter Handkes për veprën që ka krijuar dhe jo për atë që Handke është personalisht.

Tutje thuhet se ndarja e një çmimi të tillë është bërë në përputhje të plotë me testamentin që e kishte lënë Alfred Nobel.

**MË POSHTË E GJENI LETRËN E PLOTË TË AKADEMISË SUEDEZE DËRGUAR KREUT TË ASHAK-UT, MEHMET KRAJËS:**

*I nderuar Z. Kraja,*

*Ju faleminderit për shqetësimin tuaj të sinqertë. Komiteti i Nobel-it i ka vlerësuar qëllimet që qëndrojnë pas veprës letrare të zotëri Handke në mënyrë tjetër nga ju dhe Komiteti ka arritur në përfundimin se vendimi për dhënie të çmimit për të është në pajtim të plotë me qëllimin e shprehur në testamentin e Alfred Nobelit. Është e qartë se Handke kuptohet në mënyra të ndryshme. Çmimi Nobel ndahet për arritje. Kur një Handke shpërblehet me çmim, synimi është të vlerësohet vepra e tij e jashtëzakonshme letrare, e jo personi. Çmimi Nobel*

*për fizikë ose kimi ndahet për zbulim, pavarësisht nga personi; çmimi në letërsi ndahet për zbulimin dhe zhvillimin e një mënyre të re të shkruarit, pavarësisht nga personi. Vetëm vlerësimi estetik dhe asgjë tjetër përpos këtij vlerësimi është mesazhi që nënkupton ndarja e këtij çmimi.*

*Komiteti beson se në një shoqëri të hapur duhet të ketë vend për mendime të ndryshme për autorët dhe se duhet të ketë vend për interpretime të ndryshme dhe të arsyeshme të veprave të tyre letrare. Ne duhet të përpiqemi të respektojmë secilin, pavarësisht nga pikëpamjet e krejtësisht të ndryshme për çështje të rëndësishme. Në kuptim të kësaj që u tha gjithashtu besojmë se është e rëndësishme më të lartë në funksion të demokracisë dhe një dialogu të arsyeshëm që ne kemi vendosur të mbështetemi në gjetjet e ligjshme të gjykatave të tilla si Tribunali i Hagës. Gjetjet e Tribunalit për ne janë pjesë thelbësore e të kuptuarit të historisë tragjike të Evropës, nga e cila të gjithë shpresojmë se mund të mësojmë.*

*Ju sigurojmë për respektin dhe konsideratat tona më të larta.*

**Anders Olsson**  
Kryesues i Komitetit të Nobeli

## Hapet “Ura Tibetiane” në Rugovë



Grykës së Rugovës i është shtuar një nga urat më të veçanta në Ballkan.

Nga sot vizitorët do të kenë edhe një arsye më shumë për t'i parë atraksionet në këto vende. “Ura Tibetiane” e cila është e gjatë 41 metra është e vendosur në

lartësi prej 60 metrash. Në inaugurimin e kësaj ure mori pjesë edhe kryetari i Komunës së Pejës, Gazmend Muhaxheri dhe Drejtoresha për Zhvillim Ekonomik në Komunën e Pejës, Xhenet Syka.

Ajo e konsideroi këtë urë inovacion të jashtëzakonshëm. “Jeni dëshmitarë në promovimin e një inovacioni të jashtëzakonshëm, i cili sipas normave dhe

strukturës është produkti më unik në Pejë dhe rajon quhet ‘Ura Tibetiane’, ku duhet të kalohen 80 shkallë për t’u hapur pista dhe vendkalimi për Via Ferratën më të re, e cila gjithashtu promovohet sot është Via Ferrata ‘Marimangat’.

“Kjo e begaton pakon e integruar të turizmit aventurier dhe e rrit potencialin turistik në komunën tonë”, tha ajo. / KultPlus.com





# Lamtumira mashtruese

## Ndarja nga librat është njëlloj si ndarja nga miqtë...

Oliver MOL

Libraritë me libra të përdorur gjithmonë më ngjallnin trishtim. Më dukeshin si vende me histori të harruara, të lëna pas dore, të braktisura. Sigurisht që kjo nuk është plotësisht e vërtetë, por vite më parë, kur isha akoma një shkrimtar i ri, këto vende më dukeshin si varreza: si vendet ku historitë vdisnin.

Librat që na rrethojnë tregojnë shumë për personin tonë, për atë që jemi, ose ishim. Dy javë më parë, ndërsa po përgatitesha për shpërnguljen nga Sidnej në Barcelonë, isha ulur në dyshe-menë e apartamentit duke vërtitur sytë rreth 100 ca librave që kisha blerë gjatë 6 viteve të jetesës në atë qytet. Disa ishin të këndshëm, disa tituj klasikë, shumica të trishtë.

-Do t'i fal librat, - i thashë sime mëje në telefon.

Pa diskutim që isha i trishtuar.

Por në fund kuptova se nuk i hiqja dot qafe të gjithë. Kështu i ndava në pirgje, ndërsa një nga një shikoja kopertinat, lexoja titujt dhe te ndonjë ndalesha te kapitulull i parë. Disa syresh më sollën kujtime të eksperiencave të kaluara.

Me librin "Një grua e pafat" të Richard Brautigan u ktheva edhe një herë në moshën 20-vjeçare,

kur nisa të jetoja më vete. Me librin e Haruki Murakamit, "1Q84" isha 21 vjeç, kokë e këmbë i dashuruar. Me Mira Gonzalez isha 25 vjeç, në apartamentin tim në Marrickville, shoqëruar nga kolla e fqinjët të dërrmuar nga kanceri, ndërsa unë përpiqesha të mbaroja librin tim të parë. Ja dhe "Gjërat që mbajmë me vete" e Tim O'Brien, që më sjell ndërmend kohën në Brisbane: unë 28-vjeçar në shtëpinë e prindërve, në dhomën ku u rrita, pas një periudhe të gjatë migrene të pandashme...

Këta libra më kishin ndihmuar në periudha të ndryshme të jetës; ishin bërë si nënë e babë e motër e vëlla për mua.

Këta libra ishin bota ime, mbushur me trishtim e gëzim, me dhimbje, vuajtje, lumturi, magji. Ata e kishin bërë jetën time më të lehtë. Këta libra kishin përgjigje - ose pyetje - për ekzistencën time; ishin mësuesit e mi.

Alejandro Zambra më mësoi madhështinë e qetësisë dhe nevojës për t'u dëgjuar. Valeria Luiselli me "Fytyra në turmë" më kujtoi se në krijimtari nuk ka rregulla.

Kisha edhe një libër të Jamie Mortara. U takuam në 2015-n në Minneapolis në një takim poetik. Pas atij takimi bleva librin



"Një planet", që më shkruhe në lot.

Në moment kuptova se nuk mund t'i braktisja këta libra, që nuk mund t'i çoja në varrezë, që të harroheshin, të humbin... Ndaj bëra atë që bëj gjithmonë: mora një laps dhe nisa të shkruaja.

Në pjesën e brendshme të kopertinës së atyre 10 librave shkrova mesazhe për 10 miq, duke u thënë se do të më mungonin dhe se këta libra ishin gjithçka

për mua. U shpjegova se sa më kishin ndihmuar, që më kishin bërë personin që jam sot.

Mbase kjo ishte mënyrë ime e lamtumirës, një lamtumirë mashtruese, por e vetmja që dija për tua kaluar këto histori njerëzve që i kam për zemër.

Një ditë para se të nisesha, njëri prej miqve të mi më ndihmoi të mblidhja plaçkat dhe librat e mbetur i çuam në një bibliotekë. Bibliotekari, lexoi titujt, buzëqeshi dhe më tha:

- Jam i sigurt se do t'u gjejmë strehë.

Strehë, pikërisht kjo fjalë më preku: strehë. Në atë moment kuptova që po largohesha, por nëse do të ndihesha ndonjëherë i vetmuar, i humbur ose i trishtuar, në ndonjë nga këto vendet që dikur i quaja varrezë, do të gjeja patjetër një botë të gatshme për të më pritur - mua dhe këdo tjetër.

Përktheu: Elona Qose/  
Botimeshqip

## "Joker" arkëton mbi 1 miliard dollarë, filmi më fitimprurës i të gjitha kohërave

Duket se asgjë nuk mund t'i ndalojë sukseset e kompanisë filmike, Warner Bros dhe filmit të DC-së, "Joker", kjo pasi që ky film ia doli të kalojë shifrën mbi 1 miliard dollarë, shifër kjo e fituar me shitje të biletave në box office botëror.

Sipas Box Officet Mojo, filmi nga shitja e këtyre biletave arriti të fitojë 1.017 miliard dollarë amerikan, me 694 milionë dollarë të fituara jashtë tregut amerikan.

Me këtë fitim, "Joker" u bë filmi i parë në listën e filmave më fitimprurës R-rated movie. Ky sukses u arrit përkundër asaj se në Kinë u anulua shfaqja e tij, këtë duke qenë në dijeni se ky vend siguron tregun e dytë më të madh në botë sa i përket filmit. Në Kinë, ai u anulua për shkak se ka skena shumë të dhunshme.

Filmi Joker u realizua me një buxhet prej 62.5 milionë dollarë, dhe shifra që arriti në box office

e bën atë filmin më fitimprurës të të gjitha kohërave të bazuar në strip. Me fjalë të tjera, "Joker" me këtë arritje iu bashkua tre filmave të Warner Bros, me superheronj të DC: "Aquaman" i cili u realizua në vitin 2018, e që fitoi 1.148 miliard dollarë. "The Dark Knight Rises" të vitit 2012, që fitoi 1.081 miliard dollarë dhe "The Dark Knight" të vitit 2008, që fitoi 1.005 miliard dollarë.

Filmi Joker u shfaq premiere në festivalin e 76-të të filmit në Venedik, më 31 gusht 2019, ku edhe u shpërblye me çmimin Luani i Artë. Megjithatë, ky film nxiti polemika në mes të kritikëve, ku disa prej tyre e vlerësuan si të dhunshëm, me frikën se mund të nxisë dhunë edhe në botën reale. Por përkundër kësaj, ai arriti sukses, duke u bërë kështu filmi i shtatë më fitimprurës 2019, ndërkaq i 43-ti me radhë në radhë të filmave më fitimprurës të të gjitha kohërave.



# Roderick Bailey: Si dhe nga nisi operacioni britanik për Shqipërinë e pushtuar nga fashizmi



Në dhjetor 1940 ishte "siguruar në mënyrë jo të drejtpërdrejtë" nga një zyrar i Ministrisë së Punëve të Jashtme në Beograd se Gani Kryeziu kishte marrë "një subvencion prej 10.000 dinarësh në muaj nga fondet sekrete të Ministrisë." U bë e ditur, gjithashtu, "se ai konsiderohej nga jugosllavët si një kandidat më i preferuar se Zogu për kurorën e Shqipërisë, i cili nuk parapëlqej për shkak të qëndrimit të tij jomiqësor me jugosllavët gjatë periudhës së fundit të mbretërisë". Ky është vetëm një ndër detajet që del nga libri i botuar së fundmi nga "Naimi" me titull Lufta e fshehtë në Shqipëri" me autor Roderick Bailey-n, profesori i Oksfordit për luftën e Dytë Botërore në Shqipëri. I mbështetur në dokumente, ai u mori nga Akademia e Shkencave "Çmimin për studi-

uesin e huaj" në konkursin për veprën shkencore më cilësore kushtuar antifashizmit të popullit shqiptar, botuar ndërmjet viteve 1991-2019 me rastin e 75 vjetorit të Çlirimit të Shqipërisë. Motivacioni i Akademisë, e cilësoi "Studim i thelluar në burime të rezervuara dhe në interpretime shkencore, në të cilin zbulohen anë të panjohura të rezistencës antifashiste të shqiptarëve; që u rreshtuan në kahjen më përparimtare të historisë gjatë Luftës së Dytë Botërore; përkrah kauzës së madhe botërore të aleancës fitimtare; mbështetur në fonde arkivore që paraqiten për herë të parë; me rëndësi themelore për vendosjen e një standardi të ri të rrëfimit historik; ekspertizë verifikuese prej studiuesi të specializuar për këtë fushë; vepër e shkruar me respekt për popullin

shqiptar, për njerëzit që luftuan së bashku për kauzën antifashiste, pavarësisht orientimeve të tyre". Ndërsa, sipas prof. Pëllumb Xhufit, "në kaosin e botimeve dhe interpretimeve thellësisht të politizuara që i bëhen në Shqipëri ngjarjeve të Luftës II Botërore, ky libër, me mbështetjen dokumentare të jashtëzakonshme të tij dhe me qëndrimin e distancuar dhe objektiv të autorit, vendos një rregull e një standard në rrëfimin historik, që për fat të keq ende nuk konstatohet në historiografinë shqiptare. Si i tillë, ky botim, që përkon edhe me 75-vjetorin e Çlirimit të Atdheut dhe, njëkohësisht, të fitores së aleancës botërore kundër fashizmit përbën një kontribut të vyer për shkencën historike dhe për kulturën shqiptare". fa.ni.

## Nga Roderick BAILEY\*

Sapo filluan të marrin rrugë planet për Shqipërinë, megjithëse ato u përgatitën jo aq shumë nga MI(R) se sa nga Section D (Sektori D), një departament i vogël sekret i MI6, Shërbimit Sekret të Inteljencës (Secret Intelligence Service), të cilit MI(R) iu ofrua ta ndihmonte në hapat e parë të punës mbi Shqipërinë. Misioni i Section D ishte që të shqyrtonte metoda jokonvencionale me forcat e parregullta për të krijuar shqetësime tek armiqtë e mundshëm. Në prill, në Londër, Joe Holland, kreu i MI(R) dhe George Taylor, kreu i Section D për Ballkanin, përpiluan një plan bashkëpunimi për inkurajimin e shqiptarëve brenda dhe jashtë Shqipërisë, për t'i bërë qendresë pushtimit italian. Dhe pas kësaj, qendra e planeve për Shqipërinë u zhvendos nga Londra në Beograd, kryeqyteti i Jugosllavisë, vend neutral, ku Tejlor, një biznesmen australian, besonte se kishte një komunitet të shqiptarëve të mërguar dhe emigrantë. Ai kishte, gjithashtu, besim në aftësitë e përfaqësuesit kryesor të Section D në Beograd, Julius Hanau, një tregtar armësh nga Afrika e Jugut, i cili kishte jetuar në Ballkan që nga fundi i Luftës së Parë Botërore.

Nga fundi i prillit, me anë të një letre që shërbeu si direktivë për Hanau, Tejlor përvijoi qëndrimin e ri ndaj Italisë dhe theksoi nevojën "më urgjente" për veprim "të menjëhershëm" "përpara se të dalin probleme." Section D, shpjegonte ai, do të shërbente "si një lloj pararoje" për MI(R), duke mbajtur dhe shfrytëzuar kontaktet anti-italiane, me qëllim që të fillonin luftën guerile në Shqipëri. Do të kërkonte shqiptarë të gatshëm për të bashkëpunuar, do të dërgonte furnizime lufte përtej kufirit me Greqinë dhe Jugosllavinë, do të mblidhte informacione dhe të përgatiste terrenin në përgjithësi "që të ishte i përshtatshëm për veprime ushtarake", nëse Italia hidhej në luftë. Detajet u lanë në dorën e Hanaut.

Megjithëse e njihje mirë botën e errët të çështjeve dhe politikës së Ballkanit, Hanau dinte pak për Shqipërinë dhe shqiptarët dhe kishte më pak kontakte dhe burime se sa mendonte Tejlor. Ai ishte tepër i angazhuar dhe mjaft i famshëm në Beograd, gjë që nuk e lejonte të merre pjesë me kohë të plotë në këtë sipërmarrje. Si rezultat, disa punonjës të ulët të Ambasadës Britanike në Beograd u ngarkuan me përgatitjen e revoltës në një vend, për të cilin ata,

githashtu, nuk dinin pothuajse asgjë.

I pari që ndihmës atasheu i marinës së ambasadës, nënkapiteni Sandy Glen. Ishte rreth të tridhjetave, pothuajse tullac dhe kishte kaluar dyfishin e kohës si pjesëtar i Section D. Hanau i kërkoi atij që të përgatiste një raport për Shqipërinë. "Unë nuk di asgjë për këtë vend të vrazhdë dhe e pyes veten nëse ju mund të më ndihmoni", tha Glen, duke ia shkarkuar punën ndihmës-atasheut për shtypin, 21-vjeçarit Julian Amery. Brun, i hollë dhe me tipare të mpërhta, ai ishte djali i Leo-s, Sekretarit të Shtetit për Indinë gjatë kohës së luftës. Ai ishte dhe më i ri se vëllai i tij, John Amery, që nuk gëzonte reputacion të mirë, një adhurues i fashizmit, i cili e mbuloi me turp familjen dhe u dënua më vonë me varje për tradhti. Xhulian ishte energjik dhe ambicioz, luftarak dhe me shumë lidhje në atë ambient, por me një pamje plot vetëbesim që nuk i viente dhe i krijonte atij armiqtë. Kur u nis me pushime nga Oksfordi, më 1938, ai vizitoi pjesën nacionaliste në Spanjë dhe shkroi disa artikuj për gazetën vendase. Pushtimi gjerman i Polonisë e gjeti atë duke vizituar bregdetin dalmat. Ai braktisi studimet dhe ishte nisur me nxitim drejt Beogradit me një letër në dorë nga i ati, me anë të të cilës pati sukses kur i kërkoi punë ambasadorit britanik. Deri në atë moment merrej më shumë me çështjet e shtypit. Prandaj, e prit me entuziazëm lajmin e Glenit dhe i telefonoi menjëherë Ralph Parker, korrespondent i The Times në Beograd, për ta pyetur nëse njihje ndonjë shqiptar. Parker i tha se njihje një ose dy. Atë mbrëmje i caktoi një takim me ta.

Në orën gjashtë Emeri shkoi tek apartamenti i Parkerit, i cili i prezantoi Gani Kryeziun dhe vëllain e tij, Seitin. Ganiu ishte rreth të dyzetave, shulak dhe i shkurtër, "me një pamje të çiltër dhe sjellje të qartë ushtarake", do të kujtonte Emeri. "Ishte një njeri fjalëpakë." Seit ishte më i ri, më i hollë dhe më i gjatë, "dhe nëse Ganiu ishte si ushtar, Seit ishte si diplomat." Ai kishte studiuar në Francë dhe "në zemër ishte një njeri që besonte tek socialdemokracia." [1] Të dy folën me Emerin për një orë e gjysmë. Më pas, Emeri i shkroi me kënaqësi Hanaut se "një luftë çlirimtare" mund të ishte e mundur në Shqipëri dhe se këtu, tek Ganiu, shihnte një kandidat për ta drejtuar. [2] Këta ishin shqiptarë e parë, që Emeri takoi. Megjithatë, papritmas britanikët u vunë në kontakt me një familje të shquar shqiptare që, me sa duket, zinte vendin e



duhur për t'i krijuar shqetësime italianëve. Familja e Kryezinjve ishte nga Gjakova, një qytezë tregtare me shtëpi me çati të kuqe, në Kosovë, provincën në jug të Jugosllavisë, që kufizohej me malet e Shqipërisë së Veriut, dhe kishte një ndikim dhe interes të konsiderueshëm përtej kufirit: çka iu duk ideale Section D për të realizuar kalimin e armëve dhe agjentëve. Ganiu, që ishte kreu i familjes, kishte qenë, gjithashtu, një ish-officer i ushtrisë jugosllave dhe gëzonte respekt si lider. Britanikët dëgjuan më vonë se Ministria e Jashtme Jugosllave, që nuk e kishte shumë për zemër Zogun, e kishin shenjuar atë si mbret të ardhshëm të Shqipërisë.

(Në dhjetor 1940 ishte "siguruar në

mënyrë jo të drejtpërdrejtë" nga një zyrtar i Ministrisë së Punëve të Jashtme në Beograd se Gani Kryeziu kishte marrë "një subvencion prej 10.000 dinarësh në muaj nga fondet sekrete të Ministrisë." U bë e ditur, gjithashtu, "se ai konsiderohej nga jugosllavët si një kandidat më i preferuar se Zogu për kurorën e Shqipërisë, i cili nuk parapëlqejte për shkak të qëndrimit të tij jomiqësor me jugosllavët gjatë periudhës së fundit të mbretërisë". Foreign Office drejtuar War Office, telegram, 28 janar 1941)

Në fakt, vlerësimi i rrallë që treguan autoritetet jugosllave për të do të thoshte mbështetje nga Beogradi, pikërisht për atë që Section D po përpiqej të bënte. Shpejt, britanikët, të cilëve u la mbresa Ganiu

nga gatishmëria e tij për të ndihmuar dhe qëndrimi i tij "i theksuar anti-italian," e vunë familjen Kryeziu në qendër të planeve të tyre.

Javët në vijim, sipas dokumenteve të Section D, i kaluan më tepër "duke përzgjedhur emra të disa të mërguarve me qëllim që të gjenin drejtues të mundshëm dhe vatra të rezistencës." [3] Hanau i shkroi Londrës dhe i kërkoi që "informacioni në dispozicion përsa i përket Shqipërisë mund të nxirrej nga dokumentet e Foreign Office dhe War Office dhe të na dërgohet sa më parë që të jetë e mundur." Ai donte, gjithashtu, lira, ar dhe disa harta të sakta dhe, nëse gjendej, një ekspert për Shqipërinë. [4] Disa britanikë të tjerë erdhën në Beograd, ndër të cilët dhe Glen Parker, i cili

kishte hequr dorë nga The Times për t'u bashkuar me Section D, John Bennett, një avokat i ri i ambasadës, dhe Fred Laërence, një kapiten i Royal Tank Regiment. Lorëns, sipas Emeri, kishte qenë vetëm njëherë në Shqipëri për pushime.

Megjithatë, u bënë hapa përpara. Një listë e "drejtuesve potencialë", e hartuar nga mesi i majit, përbante disa emra të tjerë, përveç atyre të familjes Kryeziu. Një nga njerëzit e përfolur ishte Mustafa Gjinishi, një i ri komunist, anglishtfolës, që jetonte si i mërguar në Jugosllavi, i cili u angazhua me rekomandimin e Seit Kryeziut. Një emër tjetër ishte Abaz Kupi, që flitej se ishte në Stamboll dhe mendohej se ishte besnik i mbretit Zog. "Jemi informuar se ai do të bëjë shumë nëse do t'i jepen municione." Kupi ishte nga Kruja, një zonë malore e afërt me krahinën e Matit, prej nga vinte Zogu. Pas disa vitesh në arrati si i jashtëligjshëm dhe në disa raste dhe kundërshtar i mbretit, reputacioni i tij në vend ishte rritur aq shumë sa Zogu e bëri major në xhandarmëri. Duke patur këtë rol, Kupi, me sa duket, kishte drejtuar mbrojtjen e Durrësit në prill 1939. Edhe ai shpejt do të punonte me britanikët. Emeri do ta kujtonte si një njeri trupshkurtër, rreth të pesëdhjetave, të këndshëm, miqësor dhe analfabet, që i ngjante pak Napoleonit: "një ngjashmëri e theksuar nga një tufë flokësh të krehura mbi ballë për të fshehur vragën e thellë të shkaktuar nga një plumb." Në verë u financuan tre grupe, ku përfshiheshin dhe njerëzit e Ganiut, që të punonin në Shqipëri prej Jugosllavisë. Futja e armëve mund të fillonte kurdo që ta shihnin të arsyeshme. Dhe nga korriku, Beogradi kishte besim se "një revoltë në disa zona kufitare të Shqipërisë

mund të ishte e mundur." Ganiu kërkonte 3.000 sterlina të arta që t'ia shpërndante krerëve të Veriut dhe 40.000 të tjera sapo të fillonte "revolucionin." Ishte ofruar, gjithashtu, nga "autoritetet e larta ushtarake jugosllave" furnizimi me pesë mijë pushkë "të pajisura me rripa dhe bajoneta," dhjetë milionë fishekë dhe njëzet e pesë automatikë të lehtë. Furnizuesi do të paguhej kur ngarkesa të kalonte përtej kufirit. Duke marrë parasysh rrjedhën e ngjarjeve gjetkë, u duk se kishte ardhur koha e duhur për të goditur. Lufta nuk po shkonte mbarë për britanikët. Në maj, pasi sulmuan Danimarkën dhe Norvegjinë, gjermanët u futën në Francë dhe në Vendet e Ulëta, si dhe filloi tërheqja dhe sprapsja e forcave të ekspeditës britanike nga kontinenti. Më 10 qershor, Italia më në fund hyri në luftë në anën e Gjermanisë. Dy javë më pas, Franca firmosi një armëpushim, duke e lënë Britaninë që të vazhdonte e vetme luftën. Por, megjithëse Italia ishte tashmë një kundërshtar, strategjia britanike në Mesdhe mbeti e fokusuar për momentin në mbajtjen e luftës larg nga Ballkani, për aq kohë sa të ishte e mundur. Kështu, kur lajmi për planin e një revolte në Shqipëri arriti në Kajro, gjenerali Sir Archibald Wavell (Uovell), Komandant i Përgjithshëm i Komandës Aleate në Lindjen e Mesme, nën përgjegjësitë e të cilit përfshiheshin operacionet në Ballkan, mori menjëherë vendim që të ndalej. Doli udhëzimi që "të mos ndërmerrej asnjë veprim që nxiste revoltë për momentin." /gsh.al

(\*Autori është historian, Universiteti i Oksfordit, Britani e Madhe. Pjesa është marrë nga libri "Lufta e fshehtë në Shqipëri", i Roderick Bailey, botimet

## Librat më të mërzitshëm sipas lexuesve

Të jemi të singertë, të gjithëve na ka ndodhur të lëmë përgjysmë një libër që nuk e shtyjme dot më dhe të nisim një tjetër. Sado të mundohemi ta çojmë deri në fund, ndonjëherë është thjesht e pamundur. Të kuptohemi, fajin e ka autori. Nga sondazhet e shumta të realizuara nga faqe të rëndësishme letrare vihet re se disa libra, për lexuesit, janë vërtet të mërzitshëm. Dhe nuk ka rëndësi fare nëse një libër është klasik, nëse autori është fitues i dhjetëra çmimeve, përfshirë edhe Nobel, kur një libër nuk shtyhet, nuk shtyhet.

Ja disa nga librat që më shumti lihen përgjysmë nga lexuesit dhe motivet përkatëse.

### 1. 100 vjet vetmi – Gabriel García Márquez

"E kam nisur kaq shumë herë, por



nuk arrij kurrë ta çoj deri në fund. Thjesht nuk mundem"...

### 2. 50 hijet e Greit – E. L. James

"Pas faqeve të para e lashë, është një libër i shkruar keq".

### 3. Katedralja e Parisit – Victor Hugo

"Sa herë e marr në dorë ta lexoj, të paktën 30 faqet e para që nuk kanë asgjë veç përshkrimit të qytetit, që më cingërit nervat".

### 4. Zonja Bovari – Gustave Flaubert

"E kam nisur 3 herë, e kam lënë 3 herë. Herën e katërt vendosa ta çoja deri në fund si një sfidë personale. M' u duk si një përjetësi".

### 5. Mos lëviz – Margaret Mazzantini

"E treta e vërteta. Me dhimbje, por herën e tretë arrita ta përfundoja. U pendova... që e përfundova".

### 6. Ndiq zemrën – Susanna Tamaro

"Me thënë të drejtën nuk e lashë përgjysmë, por më mërziu dhe nuk më përcollti asgjë. Libër pa sens".

Për ta mbyllur, nuk ka libra të këqij, ka libra për çdo moment të jetës. Kam kuptuar se tani lexoj libra që 10 vjet më parë më dukeshin të gjatë e të mërzitshëm, ashtu sikurse librat e mi të referuar të një dekade më parë nuk janë më të tillë.

Ndaj, nuk humbni gjë të provoni sërish! Lexim të mbarë!

Elona Qose / Botime Shqip



EURO GLASS  
SAINT-GOBAIN  
SEKURIT  
PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

# Krasniqi: Feronikeli do t'u rikthehet fitoreve

Erlind Krasniqi, zëdhënësi i Feronikelit, ka thënë se skuadra nga Drenasi është duke punuar fuqishëm që t'u kthehet rezultateve pozitive. "Ne po punojmë fort që të rikthehen rezultatet pozitive dhe besojmë se një gjë e tillë do të ndodhë që nga ndeshja e ardhshme", ka thënë Krasniqi, i cili ka folur edhe për shortin e Kupës që përballë do ta kenë Llapin, kurse ka mohuar që klubi t'ua ketë "mbyllur" gojën futbollistëve për shkak të rezultateve jo të mira në këtë edicion

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 19 NËNTOR - Skuadra e Feronikelit nuk pati start të mirë në këtë edicion të IPKO Superligës pasi nga pesëmbëdhjetë ndeshje të zhvilluara ka grumbulluar vetëm 23 pikë dhe aktualisht renditet në pozitën e gjashtë. Redaksia e sportit e gazetës "Epoka e re" ka zhvilluar bisedë me zëdhënësin e Feronikelit, Erlind Krasniqin, i cili "fajtor" për rezultate jo të mira të Klubit të Drenasit i bënë lëndimet e shpeshta dhe ngritjen e nivelit të Superligës. "Është e vërtetë që kemi pasur vështirësi në këtë fillim të edicionit, por mos të harrojmë se edhe kualiteti i IPKO Superligës është në nivel më të lartë sivjet dhe konkurrenca është shumë e madhe. Po ashtu, kemi pasur shumë lëndime që pamundësuan zgjedhjen më të mirë të futbollistëve. Sidoqoftë, ne bëmë ndryshime në shtabin teknik sepse ishte e nevojshme një frymë e re në skuadër që të mund t'i kapim objektivat pavarësisht prej rezultateve jo të mira. Presim rikonstruktiv të klubit në janar", ka thënë Krasniqi.

Klubet në Evropë, përfshirë edhe ato në Kosovë, kanë pushuar për shkak të ndeshjeve të kombëtareve të cilat mbyllën eliminatorët për Kampionatin Evropian "Euro 2020", kurse Krasniqi ka thënë se ky pushim ishte i mirë për "Niklin". "Pushimi ishte më se i mirëpritur pasi futbollistët kishin nevojë për të marrë 'frymë' nga ndeshjet kampionale dhe mund të them se na shërbeu edhe neve që përgatitjet të bëhen më lirshëm, pa stresin e ndeshjeve", ka shtuar ai.

Shorti i Digitalb Kupës së Kosovës nuk



ishte aspak i mirë për klubin nga Drenasi që është fitues në fuqi i Kupës sepse përballë do ta ketë, në rrethin e dytë, skuadrën e llapit që, po ashtu, ka synime të mëdha në këtë garë. Megjithatë, sipas Krasniqit, kjo nuk e ka shqetësuar aspak skuadrën e Feronikelit. "Shorti i Digitalb Kupës së Kosovës na vuri përballë një ndeshjeje të vështirë por, sidoqoftë, ndeshje të vështira do të vinin edhe ashtu dhe nuk jemi klub që frikësohemi nga pesha e këtyre takimeve. Pa dyshim që në objektivat e klubit është edhe Kupa e Kosovës", ka deklaruar Krasniqi.

Një tjetër dukuri që e ka karakterizuar klubin e Feronikelit është se javët e fundit ua ka "mbyllur" gojën futbollistëve që të deklarohen për medie. Lidhur me këtë fakt, Krasniqi ka

mohuar që ky veprim i klubit të ketë lidhje me rezultatet jo të mira. "Feronikeli nuk mund t'ia mbyllë gojën asnjë futbollisti dhe kjo praktikë nuk ka të bëjë me rezultatet e mira ose të dobëta, por për këtë arsye ekzistojnë bordi, zëdhënësi dhe hierarkia e klubit. Futbollistët punën më të madhe e kanë në fushë, ndërsa të tjerat, përfshirë edhe daljen në medie, është detyrësore për ta. Ne po punojmë fort që të rikthehen rezultatet pozitive dhe besojmë se një gjë e tillë do të ndodhë që nga ndeshja e ardhshme", ka shtuar ai.

Feronikeli është kampion dhe fitues i kupës në fuqi dhe skuadra që e prezantoi Kosovën në arenën ndërkombëtare, pra në Ligën e Kampionëve dhe Ligën e Evropës.

SHKURT

## Kosova U17 nuk kualifikohet në Evropian

Përfaqësuesja e Kosovës U19 nuk ka arritur të kualifikohet në "Elite Round" për Evropianin 2020. "Dardanët" e rinj, të drejtuar nga Ramiz Krasniqi në ndeshjen e tretë dhe vendimtare të fazës së parë kualifikuese, kanë pësuar humbje nga nikoqiri i kësaj faze, Uells (2)0. U19-shat "dardanë" e mbyllën këtë fazë kualifikuese me vetëm një pikë ngaqë në ndeshjen e parë kishin barazuar me Rusinë, 1-1, derisa në ndeshjen e dytë pësuan humbje të thellë nga Polonia, 4-1. Golat për Uellsin i shënuan Pinchard dhe Williamsi. Kualifikimin tutje nga ky grup e siguruan Uells dhe Rusia.

## Duka: Reja do të jetë sërish trajner i Shqipërisë

Në një intervistë për "Corriere dello Sport", presidenti i FShF-së, Armand Duka, ka theksuar se Edy Reja është trajneri i duhur për t'i besuar sërish stolin e përfaqësueses kuqezi. "Mendoj se do të jetë sërish Reja trajneri i Shqipërisë. Do të flas me të. Nuk kam pasur kurrë dyshime mbi këtë pjesë. Më vjen keq vetëm si shkoi përballë Andorrës. Të gjithë bëmë gabim që menduam se ishte një ndeshje e thjeshtë. Mbase të gjithë e kishim mendjen te stadiumi", ka thënë Duka.

## Hadergjonaj: Kosova humbi një betejë, por jo luftën

Florent Hadergjonaj ka falënderuar gjithë popullin për mbështetjen e madhe që i kanë dhënë Përfaqësueses së Kosovës në futboll. "Faleminderit populli ynë për mbështetjen e jashtëzakonshme që na keni dhënë! Të gjithë jemi krenarë prej nga vijmë", ka thënë Hadergjonaj. "Dardanët" nuk arritën të kualifikohet në Evropian nëpërmjet kualifikimeve, por një gjë të tillë mund ta bëjnë nga ndeshjet e Ligës së Kombeve. Hadergjonaj ka thënë se Kosova e humbi një betejë, jo edhe luftën. "Kemi dashur të bëjmë edhe më shumë. Kemi humbur një betejë, por jo edhe luftën. Do të vazhdojmë të bashkuar si një familje për ta bërë ëndrrën realitet, që të kualifikohemi në Euro 2020. Jeni ju ata që na keni dhënë fuqi dhe besim për ta synuar kualifikimin. Faleminderit!", ka shtuar Hadergjonaj.

## Ndeshja vendimtare për Prishtinën

PRISHTINË, 19 NËNTOR - Kampionia e Kosovës në basketboll, Sigal Prishtina, sot (e mërkurë) nga ora 19:00 do ta zhvillojë ndeshjen vendimtare në grupet e FIBA Europe Cup. Prishtinasit do të ndeshen me skuadrën gjermane Bayreuth, ku duhet të fitojnë me +9 pikë

dallim për ta siguruar kualifikimin në xhiron e radhës. Në sfidën e parë ndërmjet këtyre dy skuadrave në Gjermani kishin fituar vendësit me rezultat 97-89. Këto dy skuadra kanë nga dy fitore dhe dy humbje, prandaj sfida e së mërkurës është vendimtare se kush do të

kualifikohet tutje. Në Grupin C, Ventpils është lider me katër fitore në po aq ndeshje, kurse në pozitën e fundit është Apoel Nicosia me katër humbje. Prishtina edicionin e kaluar kishte hyrë në top-16, duke qenë suksesi më i madh për prishtinasit në këtë garë.



## Rahoveci kërkon fitoren e parë në Ligën Ballkanike

**RAHOVEC, 19 NËNTOR - KB**  
Rahoveci sonte (e mërkurë) do ta zhvillojë ndeshjen e katërt në Ligën Ballkanike. "Vreshtarët" do të jenë

mysafirë të Vllaznisë së Shkodrës, ku kërkojnë fitoren e parë në BIBL. Edhe Vllaznia është pa fitore në këtë edicion në BIBL. Takimi zhvillohet nga

ora 19:00. Ky është edicioni i parë që Rahoveci po merr pjesë në Ligën Ballkanike, kurse mori pjesë edhe në kualifikimet e FIBA Europe Cup. Rahovecasit

edicionin e kaluar ishin finalistë të Kupës dhe "Play-off"-it, kurse në këtë edicion janë liderë të Superligës me nëntë fitore dhe një humbje.



## Emërohen përzgjedhësit e përfaqësuesëve të reja

**PRISHTINË, 19 NËNTOR - BORDI I** Federatës së Basketbollit të Kosovës ka marrë vendim për emërimin e përzgjedhësve për përfaqësueset e reja të Kosovës. Përzgjedhësi i Kosovës U20 në konkurrencën e meshkujve është emëruar Mark Rodiqi, derisa i Kosovës U18 të meshkujve do të jetë Bekim Maxhuni, kurse Dritëro Sefaja është emëruar përzgjedhës i Kosovës U16 të meshkujve.

Trajneri i Bashkimit në konkurrencën e femrave, Furkan Saglik, është emëruar përzgjedhës i Kosovës U20 (femrat), derisa Edin Kërveshi do të jetë përzgjedhës i Kosovës U16 (femrat). Gjatë ditëve në vijim përzgjedhësit e zgjedhur, në bashkëpunim me drejtorin e përfaqësuesëve, Granit Rugova, do t'i zgjedhin edhe ndihmësit të secila kategori. Gjatë verës së ardhshme Kosova do të prezantohet me pesë përfaqësues te kategoritë e reja. Kosova U20 (M) do të marrë pjesë në FIBA U20 Kampionatin Evropian, Divizioni B, në Tbilisi të Gjeorgjisë, prej 10 deri më 19



korrik 2020. Kosova U18 (M) do të garojë në FIBA U18 Kampionatin Evropian, Divizioni B, që do të mbahet në Oradea të Rumanisë prej 24 korrik deri më 2 gusht 2020. Kosova U16 (M) do të garojë në FIBA Kampionatin Evropian, Divizioni C, në Prishtinë, prej 12 deri më 19 korrik 2020. Ndërkaq në konkurrencën e femrave, Kosova do të marrë pjesë me dy ekipe, U16 dhe U20, si dhe të dyja në Divizione B. Kosova U16 do të garojë në FIBA U16 Kampionatin

Evropian, Divizioni B, që do të organizohet prej 17 deri më 26 korrik 2020 në Sarajevë të Bosnje e Hercegovinës. Kosova U20 do të marrë pjesë në FIBA U20 Kampionatin Evropian, Divizioni B, në Ramat Gan të Izraelit, prej 8 deri më 16 Gusht 2020.

### PËRZGJEDHËSIT

**Mark Rodiqi - Kosova U20 (M)**  
**Bekim Maxhuni - Kosova U18 (M)**  
**Dritëro Sefaja - Kosova U16 (M)**  
**Furkan Saglik - Kosova U20 (F)**  
**Edin Kërveshi - Kosova U16 (F)**

## Clippersat dhe Houstoni bëjnë detyrën, Toronto kërkon 'play-off'-in

**TORONTO, 19 NËNTOR - SQUADRA E** Houstonit ndjek ritmin e laker-save në Konferencën e Perëndimit, duke fituar 132-108 ndaj Portlandit, duke konsoliduar vendin e dytë. Ndeshje e dominuar nga ekipi teksan, ku u dallua Hardeni me 36 pikë, mbështetur nga Westbrook me një "triple double" (28 pikë, 13 rebounde e 10 asistime). Për Houstonin u dallua edhe Capela me 22 pikë e 20 rebounde. Fiton edhe skuadra e Bostonit, që mundi 99-85 Phoenixin jashtë fushës. Tatum me 26 pikë e 14 rebounde ishte lider në fushë për ekipin e Celticsit. Mirë po paraqitet edhe



ekipi i Clippersave, që në sekondat e fundit fitoi ndeshjen me 90-88 ndaj Oklahomas. Ndeshje me rivalitet, me diferencën e Harrellit, me 28 pikë e 12 rebounde, edhe pse e nisi ndeshjen nga stoli. Fitore të rëndësishme arriti edhe

skuadra e Dallasit ndaj San Antonios (117-110), me Donqiq që realizoi 42 pikë, 11 rebounde e 12 asistime. Pa problem fitojnë edhe kampionët e Torontos, që e "shpartalluan" Charlotten (132-96).

### REZULTATET

New York - Cleveland	123-105
Brooklyn - Indiana	86-115
Toronto - Charlotte	132-96
Chicago - Milwaukee	101-115
Houston - Portland	132-108
Dallas - San Antonio	117-110
Phoenix - Boston	85-99
Utah Jazz - Minnesota	102-112
Clippers - Oklahoma	90-88

### SHKURT

#### Shaqiri i bashkohet Xhakës dhe Mustafit në Arsenal

Xherdan Shaqiri duket se po i kalon ditët e fundit në skuadrën e Liverpoolit, pasi në afatin kalimtar të janarit ai pritet të largohet nga "Anfield Road". Shaqiri nuk po ka minuta të mjaftueshëm në formacionin e Jurgen Kloppit, prandaj largimi duket rruga më e mirë për të. Interesim kanë shprehur disa klube, por Arsenali mbetet favoriti për t'i siguruar shërbimet e reprezentuesit të Zvicrës. Në Arsenal, Shaqiri do t'i gjejë edhe dy futbollistët e tjerë shqiptarë, Granit Xhakën dhe Shkodran Mustafin.

#### De Rossi te Boca Juniorsi deri më 2021

E ardhmja e Daniele de Rossit te Boca Juniorsi pritet të vijojë edhe për dy vjet në Argjentinë. Sipas të përditshmes argjentinase "Ole", mesfushori do ta shfrytëzojë klauzolën e rinovimit të kontratës me Bocan, duke e bërë të vlefshme deri në dhjetor të vitit 2021. Klubi argjentinase, pasi u eliminua nga River Plate në gjysmëfinale të Copa Libertadores, për momentin kryeson kampionatin argjentinase. Sezoni i parë i De Rossit, duke marrë në konsideratë edhe dëmtimet, nuk është për t'u mbajtur mend, madje është folur shumë edhe për kthimin e tij në Itali në muajin janar. Drejtuesit e Bocas e shohin ish-kapitenin e Romës një figurë shumë të rëndësishme në dhomat e zeshjes.

#### Kluivert: De Lighti u pendua që zgjodhi Juven para Barçës


Patrick Kluivert pretendon se qendërmbrojtësi holandez Matthijs de Ligt është penduar që vendosi të transferohet në Juventus dhe jo në Barcelonë gjatë afatit kalimtar të verës. Barça ishte favorite për ta transferuar holandezin në verë, por De Ligtin vendosi ta vazhdojë karrierën në Juventus. "Unë personalisht nuk tentova ta bind atë t'i bashkohet Barcelonës. Unë vetëm ia tregova anën pozitive të Barcelonës, si klub dhe si qytet", ka thënë ish-sulmuesi i Milanit në një intervistë për mediumin spanjoll, "Mundo Deportivo". "Natyrshet, ne po flasim për një mbrojtës të mrekullueshëm dhe në fund ai e mori zgjedhjen e tij. Mendoj se ai është penduar paksa tani, por kjo është mënyra se si shkojnë gjërat. Në jetë t'i bën zgjedhje, nganjëherë të mira e nganjëherë të këqija. Ti duhet të mësosh nga gabimet e tua", ka shtuar Kluivert.

#### Enrique kthehet në krye të Spanjës

Luis Enrique do të rikthehet në krye të kombëtares së Spanjës për Kampionatin Evropian që do të zhvillohet në verë e ardhshme. Pesë muaj më parë Enrique dha dorëheqje nga "La Roja" në muajin qershor për shkak të sëmundjes së vajzës së tij Xana, e cila ishte prekur nga kanceri e që ndërroi jetë më 29 gusht. Që nga 19 qershori, Spanja është drejtuar nga Robert Moreno (ndihmës i Luis Enrique), nën drejtimin e të cilit përfaqësuesja iberike arriti të kualifikohet në finalen e Euro 2020. Një muaj më parë Moreno pat deklaruar se "nëse Luis Enrique do të vendoste të kthehej, do ta hapte krahun". Sipas Cadena COPE, Federata Spanjolle e Futbollit, ka kontaktuar me Enriquen, duke i kërkuar të kthehet në krye të ekipit. Tekniku mësohet se është përgjigjur pozitivisht. Vendimi mund të bëhet zyrtar pas përfundimit të ndeshjes së fundit në grup me Rumaninë.

#### Silva zbulon prapaskenat e transferimit në PSG

Thiago Silva ka rrëfyer për "Le Parisien" prapaskenat e transferimit të tij nga Milani te PSG-ja tetë vjet më parë. Më shumë sesa vendimi, brazilianin e kanë shqetësuar pyetjet e shpeshta të Zlatan Ibrahimoviçit, pasi kujtojmë se suedezi ishte së bashku me mbrojtësin pjesë e "paketës" që u transferua nga kuqezinjtë te kryeqytetasit e Francës. "Më kujtohet që Ibrahimoviçi më telefonoi dhe më tha: 'Vërtet do të shkosh te PSG-ja?', ndërsa unë i thashë: 'Po, është punë e kryer, sepse sapo kam nënshkruar'. Më pas më tha: 'Se mos është shaka?! Unë nuk firmos nëse nuk vjen edhe ti në Paris. Dhe diçka tjetër. Nëse më ke gënjer do të vij të të gjej kudo që të fshihesh'", ka deklaruar Thiago Silva.

	<b>Autor: GAZMEND MORINA</b>		KËNGËTARJA JONË .... LILA	BYREKU ME LAKRA TË GRIRA	VEGËL MUZIKOR, BORI	LLOJ PAPAGALLI	SILIC	NJËSIA PËR MATJEN E FUQISË SË RRYMËS ELEKTRIKE	LUMË NË SHBA E KANADA ME UJËVARA ATRAKTIVE	INTER	<b>EPOKA E RE</b>	BASHKË, ME (bised.)	MIMOZA MUSTAFA	
	QYTET NË SHQIPËRI										TIM MONTGOMERI NË KËTË MOMENT			
	DHËNIA E NJË ÇMIMI TË LARTË										AKTORI ... HANKS FUTBOLLISTI SPANJOLL SERGIO			
	KRIMB TOKE QË VIHET NË MAJË TË GREPIT PËR TË NDJELLË PESHKUN							PRIMITIV FSHATI KU NDODHET AEROPORTI I TIRANËS			◯			MODEJA & AKTORJA E FAMSHME PARAGUAIAINE RIQUELME
	DUKATI							ISH PRESIDENTI AMERIKAN RONALD BASHKËT.			◯			BASHKËT. DIÇKA QË BURON NGA DIÇKA TJETËR
	<b>EPOKA E RE</b>	ZANORE EMËR MASHKULLI MYSLIMAN						TRUP GJEOMETRIK USHTRIA			◯			
LLOJ PAPAGALLI							AKTORI I FAMSHËM ROBERT I AFROVA (bised.)			◯			EMI ROSUM PASURITË E PATUNDSHME QË SILLNIN TË ARDHURA (vjet.)	
KLUB I YNI FUTBOLLI										◯				
<b>EPOKA E RE</b>	SHPËRTHIM I FUQISHËM	SHKENCA MBI PAQEN	ISH FUTBOLLISTI KROAT .... KOVAÇ (BAYERN MUNICH)	↓	FUTBOLLISTI GRANIT BRITMË E LOPËS	ILIRIDA ZANORE	VËLLIMI, SASIA TENISTJA JUSTINE				EMOCIONOH-EM; MË LË MBRESA DIÇKA; MALLËNGJ-EHEM	RADIOLOGY INFORMATION SYSTEM LËRE (bised.)		
MAKINË QË SHNDËRRON ENERGINË MEKANIKE NË ENERGI ELEKTRIKE							FUTBOLLISTI MARTINEZ (B. MUNICH) FLETORË PËR SHËNIME DITORE							QYTET SHQIPTAR NË MAL TË ZI PËRGJIGJE NË TELEFON
KITARISTI I FAMSHËM KLEPTON (shq.)						HAPËSIRË E MADHE UJI (shq.) TËRËSIA E NJOHURIVE TË FITUARA; DIJE								KËNGËTARJA E FAMSHME FRANKLIN AVULL QË DEL NGA TOKA
QYTET I SHENJTË I MYSLIMANËVE						FUTBOLLISTI ANTONIO (UDINESE) FUTBOLLISTI YNË FREDERIK (MAN. UTD.)						SHKRONJË GREKE ANNA MICHELLE		
"N" në mes të dy "O"						QYTET NË KOSOVË (pashq.) PUNË A VEPËR MIZORE; KËRDI								JURIST QË JEP NDIHMË PËR ÇËSHTJE TË DREJTËSISË I ÇEL
SËMUNDE E RËNDË NGJITËSE (pashq.)			GAZ NATYROR I THJESHTË, PA NGJYRË E PA ERË (shq.) SHTET NË EVROPË											ZANORE FUTBOLLISTI .... MEHA (shq.)
I ÇMENDUR, I TRANUAR							BANESË E VEÇANTË E GRAVE TË SHEIKËVE GRYKA E VULLKANIT							ERMELINDA MEKSI PRINC ARAB
PUSHKË E GJATË ME PESË FISHEKË							LAPS							FIGURË SHAHU GJAKËS
<b>EPOKA E RE</b>	ANËTARËSIM NË NJË ORGANIZATË	PJESË E LIMANIT SËMUNDJA E TUBERKULOZIT				RANCHO PENASQUITOS BASKETBALL KËNGËTARJA MERITA .....								JETA E QETË DHE E LUMTUR (libr.) GROSETO, IVREA
DËMTIM I NJË MAKINE GJATË KOHËS SË PUNËS OSE GJATË LËVIZJES						KAPËRDIJ ISH PIKTORI SHQIPTAR .... CAPO								ZANORE VENDLINDJA E ODISEUT
KËNGËTARJA AUSTRALIANE .... MINOGUE (shqip.)						DJALLI (hebr.) KAFSHË E VOGËL SHTËPIAKE								SHKRIMTARI KELMENDI SHTET NË AZI (pashq.)
ERBIUM, INTENSITET						BOJAXHIU SOCIETY ECONOMIC DYNAMICS								KONFERENCË ME KARAKTER NDERKOMB-ËTAR (shq.) KORNIZË
VRANËSIRË						IRONIA E HIDHUR DY BASHKËTINGËLLORE								DUKURI E RE DY BASHKËTINGËLLORE
IDIOTI, DEBILI														FUTBOLLISTI I NJOHUR BRAZILIAN (R. MADRID) BASHKËT.
DYSHEK I MBUSHUR ME KASHTË QË SHTROHET PRANË VATRËS (shq.)														KUNDËRSH-TAR I PËRBETUAR
														KUNDËRSH-TAR I PËRBETUAR
														SECILA NGA PJESËT E NJË NDËRTESE, QË NGRIHEN NJËRA MBI TJETRËN

RESTAURANT

# SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



## Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

facebook  [www.facebook.com/gjeipuneshpejte](http://www.facebook.com/gjeipuneshpejte)

# Lume's Details

## Estetik & Depilim



044 900 978 | 045 687 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokal në qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira në qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel: 044/171-328.

► Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

► Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

► Lëshoj banesën një dhomshe me qira, në lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroji i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

► Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.

► Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo, ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet. Për info: 045/699-221.

► Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qërimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.

► Lëshohet banesa me qira në Prishtinë në lagjen "Ulpiana", afër AAK-së. Për informata lajmërohuni në tel: 044/162-783

► Lëshoj banesë me qira në Ulpianë, tek Fontana në: E 30-3A, nr.27, kati -IV-. Çmimi sipas marrëveshjes në info: 044-132-368.

► Kërkoj dy bashkëbanuese, mundësisht të cilat janë duke punuar. Banesa gjendet në qendër të qytetit në Prishtinë përball Prokurorisë së shtetit (ish-ndërtesa e OSBE-së, ose ish-ndërtesa e Bankës së Lubjanës), rruga "Hajdar Dushi", afër shtabit kryesor të Policisë së Kosovës. Banesën mund ta shihni çdo ditë. Numri i telefonit: 049/402-518.

► Shesim banesën dy dhomshe në Ulpiana D8 h3 Nr 15 kati 3 ndërtim i vjetër, e rinovuar komplet, me nxemje të qytetit, çmimi 77 000€. Informatat tel:049/400-958 dhe 044/627-387

► Lëshoj banesën e pamobiluar (garsonierë) me qira. Banesa, e cila gjendet rrugës për në Gërmi, 150 metra afër Kolegjit Amerikan A.U.K, ndodhet në katin 5. Çmimi 130 euro. Tel: 049/705-503 dhe 049/662-211.

► Lëshoj garsonierën me qira 13 m2 kati i IV (katër) në Lagjen Ulpiana. Çmimi 150 euro. Për info: 044/637-546.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Ulpiana objekti C7 kati i 3 hyrja e II-të nr 11 ka 50 m2 dy dhomshe, një banjo, kuzhinë të gjitha të reja, është e përshtatshme për zyre edhe apo ordinancë. Për informata nr tel; 044/641-524 dhe + 46705793508.

► Kërkoj punëkryes për ndërtimin e serrës 4000 metra katrorë. Shefqet Shala, B.I.- Skenderaj. Tel.044-499-713.

► Kërkoj punëkryes për ndërtimin e serrës 4000 metra katrorë. Hasan Osmani, B.I.- Skenderaj. Tel. 044-355-579.



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

